



PRISHTINA

.....

RAPORTI I PUNËS SË KRYEQYTETIT

Janar – Korrik 2022

.....

***KY RAPORT PASQYRON
TË ARRITURAT E EKIPIT
TË KRYEQYTETIT***

Prishtinë
Gusht, 2022

FJALA HYRËSE E KRYETARIT PËRPARIM RAMA



Qytetarë të Kryeqytetit,

Si rezultat i gjashtë muajve të angazhimit në shërbim të qytetit dhe të fshatrave të Komunës së Prishtinës, po ju prezantojmë raportin e plotë të gjashtë muajve të parë të punëve dhe projekteve të përmbyllura, të atyre që janë në stadi të ndryshme të zhvillimit, si dhe të planifikimit.

Raporti ndahet në dy pjesë: në të parën, të ndara sipas sektorëve përkatës, prezantojmë arritjet kryesore të këtij gjashtëmujori në nivelin e Institucionit të Kryeqytetit, kurse të dytën paraqiten projektet dhe planet e mëtejme sipas drejtorive përkatëse.

Një gjë që e pohojmë jo pa krenari, janë arritjet dhe sistemimet e shumta e të shumëllojshme të projekteve që prezantojmë në këtë raport.

Ndër të mëdhatë e projekteve infrastrukturore, kemi përcjellë gjithë materialin ofertues për ndërtimin e Rrugës 'A'. Mes shumë rrugëve të ndërtuara e në ndërtim, përfunduar për 40 ditë edhe rrugën 'Muharrem Fejza'. Nënshkruam kredi të butë BERZh-in për projektin e efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike, kurse me MMPHI lidhëm marrëveshjen për realizimin e projektit "Unaza e Mesme e Prishtinës". Me Bankën Botërore dhe SupërEien kemi nisë diskutimet për zgjatimin e shëtitorës 'Nënë Tereza'.

Shumë nga hapësirat, rrugët, trotualet e sheshet publike janë liruar nga uzurpimi i paligjshëm. Ndër ta është atriumi i Pallatit të Rinisë, tashmë i kthyer në shesh loje për fëmijët. Janë heqë e po hiqen shitësit ambulante, ndërtesat e braktisura po revitalizohen

dhe po profilizohen. Ndër këto vlen të përmenden Tullëtorja, ish-biblioteka 'Hivzi Sulejmani', si dhe ish-kinema Rinia, që kthehet në pronësi të Kryeqytetit.

Ka filluar procesi për caktimin e Arkitektit të Qytetit, me Policinë e Kosovës kemi vendimin e përbashkët për vëzhgimin me kamera të hapësirave publike, është vënë në binarë edhe procesi për ndërtimin e Spitalit të Kryeqytetit, të Pallatit të Operas dhe Baletit, tre soliterat ikonikë me dy ndërtesat shoqëruese shumëbanesore po rinovohen, projekti HeatSave i Termokosit po ec mbarë, procesi për një revitatizim dinjitoz të Tregut të Gjelbër është inicuar, kemi ndarë lokacionin për Liceun Artistik dhe kemi bërë ndërhyrje infrastrukturore në shumicën e shkollave në gjithë territorin e Komunës, kemi subvencionuar shtimin e serrave në zonat rurale, kemi të dhëna empirike për jetësimin e Unazës së Brendshme të qytetit, si dhe po i shtojmë bashkësitë lokale në fshatra e në lagje të qytetit.

Jo më pak të rëndësishme janë diskutimet publike që zhvillojmë me banorët e lagjeve dhe te fshatrave të ndryshme, që duke ofruar qasjen “nga poshtë-lart” e informojnë dhe e orientojnë punën tonë të ardhshme.

Në fushën e kulturës Prishtina pati një verë si kurrë më parë – festivale që Prishtinën e vunë në qendër të mediave botërore, arritje e madhe kjo për ndryshimin dhe ndërtimin e një imazhi të ri ndërkombëtar të Kosovës. Ndër këto festivale është Manifesta, bienalja që ende vazhdon duke sjellë artistë me renome botërore. Tjetra është Festivali Sunny Hill, që po ashtu solli artistë të rangut botëror dhe mijëra vizitorë në Prishtinë. Nënshkruam edhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes 'Sunny Hill Foundation', për t'i promovuar artistët vendorë drejt majave të muzikës botërore. Bashkëpunime ndërkombëtare na sollën edhe festivali Ramë Lahaj and Friends si dhe Chopin Piano Fest. Jo më pak të rëndësishme për kulturën kombëtare ishin festivali i Gastronomisë ose i EtnoFestit, të sponsorizuara nga institucioni ynë.

Megjithëse të ndara në sektorë të veçantë, projektet asnjëherë nuk janë veç infrastrukturore, shëndetësore, kulturore, ose bujqësore fjala vjen. E përbashkëta kryesore e të gjithave është se përmirësojnë dhe e shtojnë cilësinë e jetës së qytetarëve tanë.

Jemi të vetëdijshëm se edhe shumë punë, të vogla e të mëdha, i kemi përpara. Por ne jemi të zotuar që Prishtinën ta transformojmë dhe është ky fillim i mbarë ai na jep kurajon e vetëbesimin që asnjëherë të mos ndalemi.

Sinqerisht,
Përparim Rama
Kryetari i Kryeqytetit

Manifesta 14
Prishtina 2022

22.07 → 30.10.2022



Prishtina Kryeqytet i Artit e Kulturës

- **Manifesta 14:** Prishtina është vendi i parë në Ballkan që mirëpret një bienale të nivelit të tillë, prandaj për mua si Kryetar i Kryeqytetit, ishte një privilegj dhe përgjegjësi e madhe. E tërë vëmendja e mijëra gazetarëve nga mediat më prestigjioze botërore është kthyer kah Kryeqyteti ynë, i cili ishte dhe është këto ditë (deri me 20 Tetor) qendër e artistëve me renome botërore, të cilët artin e tyre e kanë sjellur këtu për qytetarët tanë. Prishtina po vizitohet nga vizitorë të të gjitha shteteve të botës, jo kalimthi si qytet ballkanik, por si referencë e parë, si qytet i artit, arkitekturës dhe si qytet i bienaleve me nam ndërkombëtar. Ne, si qytetarë por edhe si Komunë, e dëshmuam edhe njëherë potencialin, gatishmërinë, mikpritjen dhe energjinë unike që ka Prishtina.
- **Sunny Hill Festival:** Ka qenë nder dhe kënaqësi tejet e madhe me e mirëpritë në Kryeqytet, në shtëpinë tonë të përbashkët, krenarinë e Prishtinës, e të tanë Kosovës, të mrekullueshmen **Dua Lipa**. Jemi krenarë që ishim nikoqirë të një festivali si Sun-



ny Hill Festival, i cili na sjelli yjet më të mëdha të muzikës në botë, duke e shndërru kështu Prishtinën në kryeqendër të rëndësishme botërore të skenës muzikore. Poashtu, me Dua Lipën kemi nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes Kryeqytetit dhe 'Sunny Hill Foundation', e cila nëpërmjet krijimit të infrastrukturës dhe mundësive, ka për qëllim mbështetjen dhe promovimin e artistëve të rinj vendorë në rrugëtimin e tyre drejt majave më të larta në skenat botërore të muzikës.

- **Ramë Lahaj and Friends Festival:** Me tingujt e bukur të muzikës operistike dhe këngët shqipe të përpunuara dhe të interpretuara mjeshtërisht, Ramë Lahaj dhe miqtë e tij, bashkë me Filharmoninë e Kosovës, dhuruan një program madhështor dhe emocionues të forta për mijëra qytetarë në Prishtinë. Jam shumë i lumtur që Komuna e Prishtinës ishte përkrahësja më e fuqishme e **Ramë Lahaj International Opera Festival** për këtë vit, dhe do të vazhdojë të mbetet e tillë edhe më tutje. Prania e artistëve të mirënjohur botërorë, si Sopranot Pretty Yende dhe Anna Bondarenko, Maestro Jean Bernard Thomas, Baritoni Franco Vassallo e Dirigjenti Valerio Galli, Erza Muqolli dhe vetë Ramës këtu, e ka vendosë Prishtinën tonë në harta botërore, duke e shndërruar atë në një pikë fokale të rëndësishme për zhvillimin e artit e të kulturës. Me ngjarje të tilla, po e përjetojmë natyrën e vërtetë të Prishtinës: një qytet i mundësive, i të rinjve, një qytet i artit e kulturës; një Prishtinë e përjetimeve!

- **Festivali i Gastronomisë:** Festivali i Gastronomisë i cili për 10 ditë zuri vend në sheshin “Adem Jashari”, bëri bashkimin e shumë qyteteve e kulturave nga gjithë rajoni, duke promovuar traditën e kuzhinës shqiptare. Ishte një ndër ngjarjet më të bukura në qytet.
- **Gala Koncerti “Thirrje për Paqe”**, i organizuar për nder të përvjetorit të Ditës së Çlirimit të Prishtinës dhe gjithë Kosovës, na çoi në një udhëtim në kohë nëpër kujtime që kanë lënë plagë të pashërueshme tek populli ynë. Ishte një mbrëmje tejet emocionuese për të gjithë ne! Dita e Çlirimit është bërë simbol i fitores së të mirës ndaj të keqes, e për më shumë, është bërë faqja e parë e një kapitulli krejt të ri, të cilin tashmë jemi duke e shkruar të gjithë ne së bashku.

- **Chopin Piano Fest Prishtina:** Ky festival, gjatë krejt kohës sa zgjati, e pasuroi skenën artistike e kulturore të Prishtinës me 15 koncerte, bashkë me shumë mësim, punëtori, konkurse për instrumentistë e për kompozitorë, duke kontribuar kështu edhe në zhvillimin profesional të artistëve të rinj të Kryeqytetit tonë. Mezi po e presim edicionin e radhës, të cilin do të sigurohemi ta mbajmë në një sallë adekuate e në kushte të denja, ashtu siç edhe e meriton një festival i tillë!

- **Festivali i Pranverës:** gjatë një fundjave fantastike në Prishtinë, me një mori aktivitësh e programesh me muzikë e energji të mirë për qytetarët tanë ndodhi “Festivali i Pranverës”. Prishtina do duhej të ishte gjithnjë e mbushun plot me qytetarë që e përjetojnë maksimalisht potencialin e saj për të pasur lëvizje të lirë, siguri e argëtim në çdo cep. Ky është vizioni ynë për Kryeqytetin. Një Prishtinë e përjetimeve, praktike, e gjelbër dhe për t’gjithë!
- **Meeting of Styles:** Për disa ditë, Prishtina ishte nikoqire e qindra artistëve të talentuar nga mbarë bota, të cilët rrugën “B” të Kryeqytetit e shndërruan në një atelie artistike ku u prezantuan stile të ndryshme të artit urban. Edicioni i 6-të i Meeting of Styles Kosovo, me moton “Truth is Light”, shoqëruar me muzikë e energji të mirë, edhe këtë vit e gjallëroi Prishtinën tonë! Kryeqyteti po vazhdon të jetë qendër e artit dhe kulturës.
- **Etno Fest:** Ndër vite festivali Etno Fest është bërë platformë qendrore për shpalosjen e kulturës materiale e shpirtnore mbarëshqiptare. Për disa ditë me radhë, festivali na ofron shfaqje, ekspozita, instalacione, performanca e diskutime mbi aspekte të etnografisë shqiptare, e të shijoni specialitete të kuzhinës tradicionale.



Prishtina Kryeqytet i Sportit

- Në Llukar kemi përruar një fushë të re sportive në shërbim të shkollës dhe komunitetit. Futboll, basketboll, hendboll, volejball e shumë sporte të tjera, të cilat banorët, e posaçërisht të rinjtë e këtij fshati do të mund t'i shfrytëzojnë. Gjatë këtij mandati do të ndërtojmë edhe shumë fusha të tjera sportive, në shumë lagje e fshatra, për të siguruar bazën e të gjithë atyre banorëve që dëshirojnë të merren me sport.
- Kemi përmbyllur dy ngjarje të jashtëzakonshme në Kryeqytet, finalen e Kupës Botërore të Hendbollit Universitar, FISU, në të cilën nga gjithsej 500 sportistë të 28 universiteteve botërore, kampionë u shpallën djemtë e ekipit të Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"! ishte një fitore e madhe.
- Në Prishtinë u mbajt turneu **3x3 Prishtina FIBA Challenger**, një turne teje emocionues në të cilin fitues u shpallën ekipi Antwerp nga Belgjika. Prishtina po bëhet qendër sportive e kulturore, dhe do të vazhdojmë të mbështesim ngjarje të tilla që ngrisin



jo vetëm vlerën e Kryeqytetit, por të tërë Kosovës!

- Kemi organizuar edicionin e pestë të **“Turneut të Verës”** në Kryeqytet, i cili organizohet nga Prishtina Football Tournaments. Turneu mbledhi plot 240 futbollistë të rinj në sheshin “Skënderbeu”. Patëm kënaqësinë që në finalen e këtij turneu të ndajmë shpërblimet për fituesit e këtij edicioni.
- Kemi organizuar ‘Turneun Ndërkombëtar të Futbollit’, për herë të parë në Kosovë! Në fushën sportive të “FC 2 Korriku”, të cilët janë edhe nikoqirë të këtij organizimi.
- Në Stadiumin “2 Korriku” kemi vazhduar punimet për zgjerimin e tribunës së shikuesve.
- Kemi ndërtuar dy fusha të reja sportive për shkollën fillore “Hilmi Rakovica”. Investimet nuk do të ndalen këtu për këtë shkollë dhe këtë lagje, ashtu siç do të jenë të vazhdueshme për secilën lagje e fshat t’kryeqytetit.
- Shumë klube sportive e Organizata Joqeveritare të Komunës së Prishtinës, janë përfituese të mbështetjes direkte financiare nga Drejtoria për Sport për zhvillimin e aktiviteteve të tyre.
- Kemi ndërtuar fushë të re sportive edhe në fshatin Grashticë. Fshatrat e Prishtinës nuk do të mbesin mbrapa në investimet tona që do t’i bëjmë në sport.



Prishtina Kryeqytet i Investimeve

- Kemi përcjellur materialin ofertues për projektin e ndërtimit të **“Rrugës A”** (ku përfshihet kolektori dhe rruga). Në kuadër të këtij projekti përfshihet rruga me të gjitha instalimet nëntokësore. Rruga do të jetë me tri korsi në një drejtim. Për autobus do të ketë korsi të veçantë, ndërsa dy korsi të tjera do të shfrytëzohen për vetura. Rruga do të ketë shtegun e biçiklistave dhe trotuarin afër saj. Po ashtu, do të ketë tre shtigje të hapësirave gjelbëruese. Rruga “A” do të ndihmojë dukshëm në shkarkimin e trafikut të Prishtinës së Re, në të cilën ndërtimi i segmentit të parë do të kushtojë rreth 8 milionë euro. Pjesa e parë e rrugës do të përfshijë segmentin nga “Veterniku” deri tek vazhdimi i “Rrugës B”.
- Kemi përfunduar projektin e Rrugës “Muharrem Fejza”! Në vetëm 40 ditë efikase të punës, ashtu siç edhe kemi premtuar, ka përfunduar asfaltimi i kësaj rruge! Përveç infrastrukturës së duhur, jemi kujdesur që kësaj rruge të mos i mungojë as gjelbërimi përreth!
- Kemi nënshkruar “Marrëveshjen e Bashkëfinancimit” me Millennium Foundation Kosovo për rinovimin dhe përmirësimin e furnizimit me energji të ripërtërishme në

ndërtesat shumëbanesore të njohura për qytetarët si **'Soliterët e Ulpianës'**. Punimet janë në fazën finale të tyre. Përveç se soliterët do të kenë një pamje më të bukur, izolimi termik me masa efikase të energjisë do të mundësojë uljen e shpenzimeve për banorët gjatë vitit dhe do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së ajrit në Kryeqytet. Intervenimi ka qenë i domosdoshëm për kullat ikonë të Ulpianës, dhe jam shumë i lumtur që bashkë me Millennium Foundation Kosovo dhe MCC jemi duke e mbështetur një projekt të tillë, nga i cili do të përfitojnë 270 familje.

- Procesin e ndërtimit të 'Xhamisë' më në fund e kemi vënë në binarët e duhur! Ky proces u shoqërua me procedura të stërzgjatura, me pajisjen e BIK-ut me kushtet ndërtimore në vitin 2017, të cilat u plotësuan me ndryshime më vonë në vitin 2020, kur edhe u pajisën me lejen për sigurimin e grupës së gërmimit. Qytetarët e lagjeve 'Dardania' e 'Ulpiana' duhet ta gëzojnë të drejtën të praktikojnë fenë e tyre në mënyrë të dinjitetshme. Andaj, jemi të lumtur që më në fund, këtë proces e përmbyllëm me lëshimin e lejes ndërtimore për ndërtimin e këtij objekti fetar.
- Kanë filluar punimet për ndërtimin e rrugës "Rahim dhe Shabi Gërbeshi" në fshatin Marec. Po punojmë në planifikimin dhe ekzekutimin e mirëfilltë të projekteve rrugore, për një Prishtinë sa më të qasshme për të gjithë!

■ Krijimi i Zyrës së **Arkitektit të Qytetit**: Janë identifikuar nevojat e shërbimeve inxhinierike/investive. Janë përpiluar termat e referencës konform nevojave të identifikuara. Lënda është në proces të prokurimit.

- Me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim kemi nenshkuar kredi të butë, për herë të parë në Komunën e Prishtinës, në shumën prej 5 milion EUR, të komplementuar nga një grant investimi në shumën prej 1 milion EUR, për të asistuar në implementimin e projektit "Korniza e Qyteteve të Gjellbra – Eficienca e Energjisë në Ndërtesa Publike në Prishtinë". Projekti ka për qëllim investimin në masat për efikasitetin e energjisë në ndërtesat publike (kopshte, shkolla dhe qendra të kujdesit shëndetësor primar) duke përmirësuar dhe ndërruar sistemet e ngrohjes, izolimin termik të ndërtesave dhe instalimin e dyerve dhe dritareve më efikase. Jemi tejet të përkushtuar për të shtyrë përpara projekte të cilat janë në harmoni me ruajtjen e ambientit, zhvillimin e qëndrueshëm dhe promovimin e energjisë efikase, për të zvogëluar nivelin e ndotjes së ajrit në Kryeqytet dhe më gjerë.
- Eshtë asfaltuar rruga "1 Tetori"! Kjo rrugë, duke qenë ndër ato më të qarkullueshmet dhe që mundëson lidhjen me disa lagje, po lehtëson qasjen e qytetarëve në kryeqytet.




- Kemi nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit mes Kryeqytetit dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është financimi i projekteve infrastrukturore si dhe përcaktimi i obligimeve të MMPHI-së dhe Kryeqytetit për realizimin e projektit **“Unaza e Mesme e Prishtinës”**, i cili është shumë i rëndësishëm për rregullimin e mobilitetit dhe lirimit të trafikut në Kryeqytet.
- Me partnerët e KFW jemi duke punuar intensivisht në zhvillimin e projektit “Solar for Kosovo”, i cili projekti ngrit kapacitetet e ndermarrjes “Termokos” edhe për 50 MW të reja.
- Po investojmë vazhdimisht në ndriçim publik! Kemi nënshkruar kontratën e re për mirëmbajtjen e sistemit, ndërsa jemi në proces të vlerësimit të kontratës përmes së cilës do të bëjmë zgjerimin e mëtutjeshëm të sistemit të ndriçimit publik, në mënyrë që asnjë lagje e Prishtinës të mos mbetet pa ndriçim.
- Hapësirat publike tani e tutje do të jenë nën vëzhgimin e kamerave! Kemi finalizuar marrëveshjen me Policinë e Kosovës për sistemin e kamerave në hapësirat publike. Tash e sa kohë jemi në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës për hartimin e marrëveshjes për vendosjen e sistemit të kamerave dhe mënyrën e mirëmbajtjes së rrjetit të kamerave në hapësirat publike të Kryeqytetit, marrëveshje të cilën kemi nënshkruar. Bashkë me Policinë e Kosovës u zotuar se do të koordinojmë aktivitete të përbashkëta për përmirësimin e sigurisë në hapësirat publike të Kryeqytetit.
- Jam i lumtur që projekti i financuar nga Millennium Challenge Corporation – MCC, për instalimin e njehsorëve të Termokos-it po shkon mbarë. Deri më tani janë insta-

luar valvula, alokatorë dhe njehsorë në rreth 2000 banesa në disa lagje të Kryeqytetit. Pajisjet dhe instalimi janë falas, dhe nga viti i ardhshëm, të gjithë konsumatorët do të paguajnë faturat e ngrohjes sipas konsumit e jo me metra katrorë.

- Kemi filluar ndërtimin e rrugës në Zllatar. Jemi fokusuar në planifikimin e mirëfilltë të saj, duke pasë parasysh edhe përfshirjen e kanalizimit dhe ndriçimit publik.
- Punimet në ndërtimin e rrugëve në fshatrat Nishefc e Keqekollë po vazhdojnë. Edhe në Buxhetin e vitit 2023 kemi planifikuar ndërtim të rrugëve në fshatrat e Prishtinës.
- Kemi filluar punimet në ndërtimin e rrjetit të kanalizimit fekal për një pjesë të fshatit Busi. Punimet do të përfundojnë këtë vit.
- Po vazhdojnë punimet në ndërtimin e rrugës “Sfirca” në fshatin Nishefc.
- Kanë filluar punimet në ndërtimin e rrugës “Brigada e Lirisë” në fshatin Keqekollë.
- Kanë filluar punimet në ndërtimin e rrugës Rimanishtë – Siqevë.
- Kanë filluar punimet në ndërtimin e rrugëve në fshatin Prapashticë.

- Po vazhdojmë me punime në lokacione të ndryshme të qytetit, ku kërkohen intervenime urgjente! Kemi përfunduar punë në rrugët “Taslixhe”, rrugën “Ahmet Derguti” dhe rrugën “Holger Petersen”. Do të jemi në çdo lagje për t’i sanuar rrugët.

- Kemi asfaltuar rrugën “Tirana” në Prishtinë.
- Kemi sanuar rrugët dhe rregulluar pusetat në rrugën “27 Nëntori” dhe rrugën “Rasim Kiçina”.
- Kemi asfaltuar rrugën “Hermine Lekaj” në Lagjen Mati 1.
- Në rrugën “Ahmet Krasniqi” kemi rregulluar hyrjen me shkallë, tek objekti i Komunës së Prishtinës, në Arbëri.
- Kemi sanuar rrugët dhe rregulluar pusetat në rrugën “27 Nëntori” dhe rrugën “Murat Mehmeti”.
- Kemi sanuar rrugët dhe rregulluar pusetat në rrugën “Vëllezërit Fazliu”, rrugën “Fehmi Agani” dhe rrugën “Ilir Konushefci”.
- Kemi sanuar rrugët dhe rregulluar pusetat në rrugën “Vushtria” dhe rrugën “Mark Isaku”.
- Kemi sanuar rrugët dhe rregulluar pusetat në rrugën “Drenica” dhe rrugën “Perandori Dioklician”.
- Kemi asfaltuar rrugën “Ahmet Krasniqi”, në Lagjen Arbëria, ku qytetarët tani kanë qarkullim më të lehtë.
- Bashkë me Kryetarin e Kamenicës, z. Kadri Rahimaj, kemi inicuar hartimin e projektit të krijimit të shtegut të biçikletave Prishtinë – Kamenicë. Ky shteg, përveç se do të ndërlihdë dy qytetet tona nëpërmjet transportit alternativ, në vete do të ngërthejë edhe një itinerar kulturor e ambiental për gjithë komunitetet.
- Objekti i KINO RINIA i rikthehet në menaxhim Kryeqytetit pas shumë vitesh. Kemi nisur menjëherë me planin e rigjenerimit të një prej ikonave të kryeqytetit.



Prishtina Kryeqytet i Shëndetësisë

- Spitali i Kryeqytetit po bëhet! Kam vizituar disa here lokacionin e dedikuar për ndërtimin e objektit. Janë duke u bërë të gjitha matjet dhe analizat e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e procesit. Punimet për Spitalin e Kryeqytetit janë duke ecur sipas planit dhe presim që ndërtimi të fillojë gjatë vitit 2023. Ekziston studimi i detajuar i fizibilitetit dhe po punojmë me donatorët për sigurimin e fondeve të plota për projektin.
- Një ndër prioritetet tona është rritja e efikasitetit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në Kryeqytet, prandaj, jemi të fokusuar që sa më shpejt të përfundojmë ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Veternik. Kam ndjekur nga afër punimet dhe jam i lumtur të ju informoj se shumë shpejt edhe banorët e Veternikut do të kenë mundësi të marrin shërbime brenda lagjes së tyre.
- Nuk do të ketë më listë pritjeje për mamografi, shërbimi ofrohet në kohë reale në QKMF dhe QMF. Me stafin e QMF-së, identifikua nevojat dhe kërkesat e tyre, në mënyrë që vazhdimisht të përmirësojmë shërbimet për qytetarët.



Prishtina Kryeqytet i Arsimit

- Për një vit të mbarë shkollor, po renovojmë edhe Shkollën “Medreseja Alauddin” në Prishtinë. Infrastruktura shkollore ka shumë nevojë për restaurim. Prandaj asnjë shkollë nuk do ta lëmë mbrapa me investime. Shtatori do të na gjejë më të përgatitur, më të përkushtuar e më të frymëzuar për të hapë horizonte të reja të diturisë.
- Punimet po vazhdojnë në shkollën “Avni Rustemi” në Mramor dhe në shkollën “Filip Shiroka” në Llajshevc. Gjithëpërfshirja dhe barazia janë parime bazë në qeverisjen tonë.
- Pas diku rreth dhjetë vitesh, po renovohet edhe SHFMU “Emin Duraku” Prishtinë. Kemi bërë intervenime në shkollën “Sami Frashëri”, “Ali Kelmendi”, “Xhemail Mustafa”, “Pjetër Bogdani”, “Hasan Prishtina” dhe “Ismail Qemali”.
- Në shkollat “Hasan Prishtina”, “Zenel Hajdini” dhe “Gjergj Fishta” është renovuar ndriçimi publik, sinjalizimi, shtyllat anti-parking, rrethojat dhe shenjëzimi, në mënyrë që shkollat të jenë më të sigurta. Siguria në shkolla është prioritet.
- Dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim në çdo shkollë dhe çerdhe të Prishtinës. Shtatori do të na gjejë me shkolla dhe çerdhe më të pastërta dhe më të sugurta për



fëmijët. Kemi fillu procesin e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit të të gjitha shkollave dhe çerdheve.

- Kemi bërë pastrimin e të gjitha çerdheve të Kryeqytetit. Kemi punuar në katër çerdhe të Prishtinës: “Buzëqeshja”, “Xixëllonjat”, “Ardhmënia” dhe “Lulevera”. Më të vegjëlit janë kthyer në çerdhe me një ambient më të dashur e miqësorë.
- Kemi punuar në ndriçimin e tërësishëm në shkollën “Gjergj Fishta” në Prishtinë. Nuk do të kemi kënde të errëta në asnjë shkollë, por do të ofrojmë siguri për të gjithë.
- Faleminderit Kosovo Foundation for Open Society (KFOS) për vendosjen e paneleve solare në dy shkolla të Komunës të Prishtinës, në Shkolla Model “Qamil Batalli” - Prishtinë dhe Shkollën “Iliria” Prishtinë. Panelet solare do të ulin konsumin e energjisë elektrike dhe do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Nuk ka vend më të mirë se shkolla që të fillojmë edukimin për eficiencë të energjisë. E ardhmja është e gjelbër, prandaj edhe investimet tona do të jenë të tilla.
- Kemi punuar në shkollën “Dëshmorët e 1921” në Prapashticë. Përveç rrethojave të shkollës, së fundmi vendosëm edhe kamerat e sigurisë, si dhe investuam në ndriçimin përreth shkollës. E gjithë kjo që siguria të jetë më e lartë dhe që fëmijët të mos ndihen të rrezikuar. Poashtu, mjedisin sportiv dhe rekreativ që ofron shkolla tani mund ta shfrytëzojë edhe komuniteti i fshatit dhe i rajonit të Gollakut.
- Kuvendi Komunal ka ndarë tre lokacionet për ndërtim të çerdheve: në lagjen “Mati I”, në lagjen “Kolovica e Vjetër” dhe në lagjen “Kolovica e Re”. Këto çerdhe do të ndërtohen me financim nga Ministria e Arsimit dhe Komisioni Evropian.



Prishtina Kryeqytet i Shërbimeve Efikase

- U themelua grupi punues në bashkëpunim edhe me aktorë jashtë strukturës komunale për trajtimin e qenve endacakë në Kryeqytet. Jemi duke e trajtuar këtë çështje me seriozitetin më të lartë, duke zhvilluar strategji afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë për zgjidhjen e problemit, mirëpo për të arritur rezultatet e dëshiruara, nevojitet bashkëpunim i ngushtë dhe i mirëfilltë me nivelin qendror dhe komunat tjera të vendit.
- Me Kompaninë Rajonale të Ujësjetësimit “Prishtina”, për të siguruar ofrimin e shërbimeve sa më cilësore të furnizimit me ujë dhe kanalizimit në tërë territorin e Kryeqytetit nënshkruam Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes dy institucioneve tona.
- Kemi ndaluar qarkullimin e trotinetëve, biçikletave dhe të gjitha mjeteve motorike elektrike nëpër sheshet dhe hapësirat publike të Kryeqytetit, në të cilat ka frekuencë

të lartë të këmbësorëve. Kjo urdhëresë ka hyrë në fuqi prej datës 15 gusht 2022, deri në votimin dhe publikimin e rregullores në të cilën jemi duke punuar për të siguruar mbarëvajtjen e qarkullimit të këtyre mjeteve sa i përket sigurisë së qytetarëve të Prishtinës, e veçanërisht sigurisë së fëmijëve.


- Kemi marrë vendimin për themelimin e zyrës koordinuese për Diasporën në kuadër të Kryeqytetit. Hapja e zyrës koordinuese për Diasporën në nivel lokal është nevojë dhe kërkesë e kahershme, andaj po përmbushim edhe një nga premtimet tona. Kjo zyrë koordinuese, e cila do të funksionalizohet shumë shpejt. Diaspora jonë, paraqet elementin më fisnik e cila gjithmonë mban lidhjen me atdheun, dhe për kontributin e tyre të vazhdueshëm jemi përjetë mirënjohës!

- Kemi nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi mes Kryeqytetit dhe DAI Global. Ky Memorandum, i cili vjen si vazhdimësi e zotimit tonë si pjesë e programit të USAID Kosovo: 'Integriteti i Komunave të Kosovës' (KMI), synon të zhvillojë më tutje transparencën dhe llogaridhënien, të cilat janë edhe parimet themelore të qeverisjes sonë. Jemi tejet të përkushtuar të kemi një qeverisje të mirë dhe transparente ndaj qytetarëve të Prishtinës, andaj bashkëpunime të tilla janë gjithmonë të mirëseardhura.
- Kemi zhvilluar takime të shumta me përfaqësuesit e "Tregut të Gjelbër". Jemi në pajtim të plotë se shitësit do të vazhdojnë të operojnë brenda hapësirave të Tregut, të cilat do të rregullohen sipas standardeve dhe kushteve të dinjitetshme, por kurrësesi në rrugë. Mirëpresim bashkëpunimin e ngushtë me të gjithë për revitalizimin e Prishtinës së Vjetër. Tregu duhet të ofrojë kushte dinjitoze për të gjithë shitësit. Kemi ndërmarrë aksionin për lirimin e hapësirave përreth, si dhe pastrimin e tyre nga mbeturinat e grumbulluara. Veç duke punu bashkë mund ta transformojmë këtë pjesë të anashkaluar të Prishtinës, andaj falënderojmë të gjithë shitësit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin që treguan.
- Brigada e Zjarrfikësve-Prishtinë, tani me pajisje të reja operuese. Kemi nënshkruar donacionin nga Komanda Ushtarake e SHBA. Uroj që këto pajisje të shërbejnë në fuqizimin dhe ngritjen e kualitetit të shërbimeve për sigurinë e qytetarëve të Prishtinës, në raste emergjente e të fatkeqësive.
- Kemi nënshkruar "Kartën për Komunën e Gjelbër dhe të Qëndrueshme" përmes së cilës synohet të përmirësohet cilësia e jetës në Komunat tona nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm urban, social dhe ekologjik. Për të përmbushur objektivat e 'Agjendës së Gjelbër' kërkohet bashkërendim i mirëfilltë mes nivelit qendror dhe atij lokal, e kjo "Kartë" ne si Komuna na vendos para një përgjegjësie tepër të madhe, të cilën, të gjithë Kryetarët e pranishëm me kënaqësi e pranuan, për një të ardhme më të mirë e më të shëndetshme të të gjithë qytetarëve dhe të brezave që do të vijnë.

- Me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës nënshkruam kontratën me të cilën i dhuruam Policisë së Kosovës pronën në shfrytëzim me qëllim të dislokimit të personelit dhe pajisjeve nga objekti i Stacionit Policor “Veriu” në lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë. Policisë së Kosovës, si institucion kyç i cili përkujdeset për sigurinë e qytetarëve, u nevojitet një lokacion strategjik për ekzekutimin sa më efikas të punës së tyre, andaj jemi më se të lumtur që t’u ndihmojmë në këtë aspekt.
- Aksioni për pastrimin dhe largimin e deponive ilegale po vazhdon në të gjithë territorin e Prishtinës. Në pjesët ku janë duke u larguar deponitë ilegale, do të shtohet inspektimi nga Drejtoria e Inspektionit dhe do të pasojnë dënime të rënda për të gjithë ata që hedhin mbeturina në vende dhe hapësira të gjelbra! Janë paraparë edhe masa të ndryshme sensibilizuese: rrethim dhe vendosje e kamerave në këto hapësira. Gjithashtu, në disa lokacione është paraparë edhe vendosja e ulëseve, verandave dhe mbjellja e drunjëve dekorativ.

- Me Agjencinë Kadastrale të Kosovës kemi nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit për plotësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të adresave në territorin e Kryeqytetit. Me ta kemi diskutuar edhe për reforma në projektligjin e kadastrit, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

- Me UNDP kemi nënshkruar ‘Memorandumin e Mirëkuptimit’, përmes të cilit u dakorduar që UNDP të na ndihmojë në transformimin urban të Kryeqytetit drejt krijimit të hapësirave dhe zgjidhjeve të qëndrueshme, të gjelbra dhe të përshtatshme për lëvizjen e lirë të qytetarëve.
- Bashkësia Lokale në Hajvali, tashmë është funksionale! Bashkë me Drejtorin e Administratës, z. Bersant Beka, bëmë hapjen dhe funksionalizimin e pikës së re të Bashkësisë Lokale në Hajvali. Banorët e këtij fshati, që nga sot do të kenë mundësinë të pajisen me dokumente personale si dhe të marrin shërbime të tjera që ofron Komuna e Prishtinës. Gjatë javëve në vazhdim do të rrisim kapacitetet e ofrimit të shërbimeve për qytetarët tanë duke shtuar pika të tjera të Bashkësive Lokale në lagje e fshatra të tjerë të Prishtinës.
- U rifunksionalizua edhe një Bashkësi Lokale! Pas dy viteve jashtë funksionit, prej sot Bashkësia Lokale në Tophane do të jetë e hapur për banorët e kësaj lagjeje. Ashtu siç kemi premtuar, me rradhë po hapim dhe funksionalizojmë bashkësi lokale në të gjitha lagjet e Kryeqytetit.
- Me EBRD jemi duke punuar intensivisht për nënshkrimin e kontratës së re për blerjen e flotes së re të autobuseve urban.



Prishtina Kryeqytet i Gjelbërt

- Prej fillimit të mandatit qeverisës, kemi qenë të angazhuar në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në kryeqytet. Në frymën e këtij angazhimi, nënshkruam 'Marrëveshjen e Bashkëpunimit' me "Fondacioni Jeshil". Me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve të Kryeqytetit në trajtimin e mbeturinave organike, sigurinë ushqimore, bujqësinë e qëndrueshme dhe zhvillimin e ekonomisë qarkore, mirëpresim bashkëpunimin në projekte të cilat promovojnë zgjidhje inovative dhe miqësore ndaj mjedisit dhe mirëqenies së qytetarëve tanë.
- Me Përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian në Kosovë, Ambasadorin Tomáš Szunyog, nënshkruam Memorandumin e Mirëkuptimit, në të cilën parashihet një kornizë bashkëpunimi në zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra në Prishtinë nëpërmjet zbatimit të projektit të përbashkët "Promovimi i edukimit për qëndrueshmërinë e gjelbër me fëmijët dhe ambasadorët e BE-së".
- Regjenerimi dhe rekultivimi i hapsirave të sipërfaqeve të gjelbërta me drunjë, shkurre dhe lule dekoruese në shumë hapësira të qytetit.

Plani Zhvillimor Komunal

Qysh prej javëve të para të mandatit, kemi filluar punën në Planin Zhvillimor Komunal, si një prej dokumenteve më të rëndësishme të Kryeqytetit. Angazhim i plotë nga ekipi im për një Prishtinë të planifikuar mirë. Në mënyrë që të kemi mendimin e secilit qytetar të Prishtinës, kemi zhvilluar takime në secilën lagje të Prishtinës, dhe këto takime po i vazhdojmë edhe këto ditë.

- Në vazhdën e takimeve me banorë të lagjeve të Kryeqytetit, kemi zhvilluar takime në lagjen **Arbëria** për të diskutuar mbi planet zhvillimore, hartat zonale si dhe rigjenerimin urban të kësaj lagjeje. Duke qenë se kjo lagje është zhvilluar hovshëm dhe po vazhdon kështu, është tejet me rëndësi që çdo cep të planifikohet me kohë dhe konform kërkesave dhe nevojave të qytetarëve. Falënderojmë çdonjërin pjesëmarrës për kontributin, idetë dhe propozimet.
- Jemi takuar me qytetarët e lagjes **“Mati”**. Idetë e propozimet e tyre do të na ndihmojnë në zhvillimin e mirëfilltë të Kryeqytetit!

- Jemi takuar me qytetarët e lagjeve ‘Prishtina e Vjetër’ dhe ‘Dodona’, me të cilët u dakorduar që në takimet e radhës të organizojmë një tryezë punuese ku idetë dhe propozimet do t’i vizualizojmë konkretisht së bashku.

- Jemi takuar me qytetarët e lagjes **“Kodra e Trimave”**. Planifikimi për të ardhmen e Prishtinës do të bëhet në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me qytetarët duke i marrë parasysh propozimet dhe idetë për zgjidhjen e problemeve kyçe në lagjet e tyre.
- Jemi takuar me qytetarët e lagjes “Kalabria”, ku me vëmendje dëgjuam propozime dhe ide nga banorët e kësaj lagjeje. Bashkëpunimi i drejtpërdrejt me qytetarët ndihmon në zhvillimin dhe zgjidhjen e problemeve të Kryeqytetit.



PRISHTINA

.....

RAPORTET E PUNËS SË DREJTORIVE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

.....

DREJTORIA E INVESTIMEVE KAPITALE

Drejtoria e Investimeve Kapitale gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2022 ka analizuar kërkesat për hartimin e detyrave projektuese dhe identifikimin e nevojave, ka shqyrtuar kërkesa të banorëve të bashkësive lokale dhe ka inkorporuar ato në planet e Komunës, ka njoftuar me kohë kompanitë publike dhe subjektet relevante, me qëllim të koordinimit të punëve. Aktivitet kyç ka qenë incizimi i gjendjes ekzistuese të infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, si dhe kompletimi i dokumentacionit teknik për procedimin e tyre në organet kompetente, mbikëqyrja e realizimit të projekteve në harmoni me marrëveshjet, përgatitja e marrëveshjeve për infrastrukturë, dhe faturimi i borxhit. Në total kemi nënshkruar 60 marrëveshje për infrastrukturë, kemi realizuar 39 detyra projektuese (të cilat janë të paraqitura në vazhdim), kemi hartuar 21 projekte për infrastrukturë rrugore dhe kemi dhënë 58 leje për gropim.

Hartimi i projekteve për infrastrukturë rrugore:

Kemi realizuar 39 detyra projektuese:

- Projekti kryesor i segmentit të parë të rrugës "A";
- Projekti i rikonstruimit të rrugës "Nekibe Kelmendi" në Prishtinë;
- Projekti i rrugës Slivove – Pështerr, dhe krahu i rrugës në fshatin Llajshec;
- Projekti i rrugës në lagjet: Zullufët, Rafunët dhe Sheqerovitët në fshatin Nishec;
- Projekti i rrugëve "Lapidari i Dëshmorit" dhe "Drini" në fshatin Sharban;
- Projekti i rrugëve të lagjeve Vrapca, Nimani, Jahiri dhe Latifi, në fshatin Prapashticë;
- Projekti i rrjetit të rrugëve në lagjen e poshtme të fshatit Sharban;
- Projekti i rikonstruimit të rrugës "Skënderbeu" në fshatin Bardhosh;
- Projekti i rikonstruimit të rrugës "Vjosa" dhe "Gonxhe Bojaxhiu" në fshatin Bardhosh;
- Projekti i rikonstruimit të rrugëve "Hazir Haxholli", "Alush Hoti", "Eva Brendli", "Bedri Dedja", dhe "Agron Rama", në fshatin Shkabaj;
- Projekti i rrugës lidhëse në mes rrugës "Hazir Haxholli" dhe "Agron Rama" në fshatin Shkabaj;
- Projekti i rrugës lidhëse me ën "Sadik Beka" në lagjen Matiqan të Prishtinës;
- Projekti i rruges "Zekë Pacolli" dhe "Zllash i ël" në fshatin Marec;



- Projekti i rrugës lidhëse me rrugën “Gani Balaj” dhe “Aleks Buda” në lagjen Sofalia të Prishtinës;
- Projekti i rrugës “Xhemajl Krasniqi”, në fshatin Grashticë;
- Projekti i rikonstruimit të rrugës “Ismail Klosi” dhe “Vidovdanska” në fshatin Bërnice;
- Projekti i rikonstruimit të rrugës “Kole Jakova” në lagjen “Qëndresa”;
- Projekti i rikonstruimit të rrugës “Holgen Petersen” dhe “Mark Raka” në Prishtinë;
- Projekti i rruges “Kosturi” dhe rrugëve lidhese me rrugën “Ferid Curri” në lagjen Arbëria;
- Projekti i rrugëve lidhëse merrrugën “Shkupi” dhe rrugën “Holgen Petersen” në lagjen Prishtina e Re;
- Projekti i rikonstruimit të rrugëve “Xheladin Rekaliu” dhe “Enver Maloku” në Prishtinë;
- Projekti i rikonstruimit të rrugëve “Hilmi Rakovica”, “Dervish Rozhaja” dhe “Thimi Mitko” në Prishtinë;

Sektori i menaxhimit të kontratave, në kuadër të Drejtorisë, gjatë kësaj periudhe është marrë kryesisht me vlerësimin e kontratave të ndërtimit të ultë, në koordinim me zyrën e prokurimit, menaxhimin e kontratave të ndërtimit të ulët, zgjidhjen e problemeve të cilat

lidhen me infrastrukturë, dhe ka ndihmuar edhe sektorët tjerë drejtorisë në vlerësimin e kontratave, menaxhimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për tenderim. Në këtë drejtim, kemi filluar implementimin e 20 projekteve, të cilat i kemi listuar në vazhdim:

- Implementimi i planit të Mobilitetit;
- Ndërtimi i rrugës “Shkëndija” në Fshatin Zllatar;
- Ndërtimi i rrugës “Arbanasi”, “Shkëndija”, “Minatori”, “A. Lioki” e “Murat Gashi”;
- Ndërtimi i rrugës “Kacaketi” në Prapashticë, Lagja Govori;
- Ndërtimi i rrugës në Lagjen “Hajdaraj”, Fshati Koliq;
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Prapashticë, Lagja Qafa;
- Rikonstruimi i rrugëve në fshatrat Bardhosh, Bernicë, Leban, Vranidoll, Barilevë dhe Mramor;
- Rikonstruimi i Rrugës “Muharrem Fejza”;
- Ndërtimi i Rrugës “Brahim Beka”;
- Ndërtimi i Rrugës “Rrahim dhe Shabi Gerbeshi”, Lagja Gërbesh në fshatin Marec;
- Ndërtimi i Rrugës në Fshatin Radashec;
- Rikonstruimi i Rrugës “Gjergj Balsha” dhe “Toni Bler”;
- Hapja e rrugëve të reja në Komunën e Prishtinës;
- Ndërtimi i rrugës që lidhë fshatrat Rimanishtë – Siqevë;
- Ndërtimi i rrugës “Svirca”, në fshatin Nishec;
- Ndërtimi i rrugës në lagjen “Xharrovitët” – në fshatin Keqekollë;
- Ndërtimi i rrugës “Brigada e Lirisë”, faza e dytë, lagja Qelaj në fshatin Keqekollë;
- Ndërtimi i parqeve rekreativo – sportive në kryeqytet, në lagjen Dodona;
- Ndërtimi i kanalizimit në fshatrat Mramor, Bardhosh dhe Prugovc;



Eshtë shumë e rëndësishme të theksojmë se për shkakë rrethanave të krijuara me inflacionin e vitit 2022, shumë prej operatorëve ekonomik të cilët kanë nënshkruar kontratë me Komunën e Prishtinës, janë tërhequr nga punimet dhe nuk i janë përgjigjur thirrjeve tona për vazhdim të punimeve, duke shkaktuar shkëputje të kontratave (konform kontratave dhe rregullave të prokurimit). Si rezultat, rreth 15 kontrata janë shkeputur.

Sektori i menaxhimit të kontratave të ndërtimit të lartë, në bazë të detyrave programore, kryesisht është marrë me përpunimin e lëndëve me problematikë menaxhimi i kontratave të ndërtimit të lartë, hartimin e detyrave projektuese, mbikëqyrjen e projekteve, mbikëqyrjen e objekteve, hapjen dhe vlerësimin e tenderëve , marrja pjese në komisionet e caktuara nga Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Drejtorisë për fushen e ndërtimit dhe veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me këtë sektor.

DREJTORIA E KULTURËS

Drejtoria e Kulturës gjatë periudhës Janar – Korrik 2022 ka iniciuar, realizuar dhe monitoruar aktivitete të ndryshme kulturore, ka bërë shënimin e datave me rëndësi, ka iniciuar aktivitete të prokurimit, ka aprovuar dhe proceduar kërkesa të institucioneve vartëse të saj, ka dhënë pëlqime për aktivitetet kulturore, ka takuar partnerë, ministri të linjës, organizata vendore dhe ndërkombëtare, ambasada, shoqërinë civile si dhe institucionet relevante në fushën e kulturës.

Gjatë muajve të parë të vitit 2022, është kryer kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara në vitin 2021 (faza e dytë për kategorinë muzikë, botime dhe teatër). Gjithashtu janë përgatitur të gjitha kontratat dhe vendimet respektive dhe janë proceduar për pagesë.



Është përgatitur thirrja e re për vitin 2022, faza e I-rë e subvencioneve:



THIRRJA PËR KULTURË:

Festivale, Mbështetje të aktiviteteve vjetore, Muzikë, Shoqëri kulturo-artistike, Trashëgimi Kulturore dhe Turizëm. Kanë aplikuar gjithsej 198 projekte dhe janë mbështetur 151 nga komisioni vlerësues;



THIRRJA PËR KULTURË:

Art vizual – figurativ, Botime, Kinematografi, Teatër. Në këtë thirrje kanë aplikuar 203 projekte, ku 93 projekte janë mbështetur nga komisioni vlerësues;

THIRRJA PËR KULTURË:

T.Q.P “Dodona”, kanë aplikuar 13 projekte, janë mbështetur 4 nga komisioni vlerësues.

Kemi realizuar disa ngjarje të rëndësishme, si: 30 vjetori i shtëpive shkolla – 27 Janar; Dita e Pavarësisë – 17 shkurt; Dita ndërkombëtare e librit për fëmijë e të rinj – 1 prill; Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve – 1 Qershor; Dita e Prishtinës – 11 Qershor; Dita ndërkombëtare e Muzikës – 21 Qershor; Koncerti me Filarmoninë e Kosovës – 26 Qershor.



Përgjatë periudhës 6 mujore janë iniciuar dhe përmbyllur këto aktivitete të prokurimit:

- “Operimi turistik”, kontrata është në implementim për 12 muaj;
- “Dekorimi i qytetit për festa”, dekorimi veror përmbillet me 15 shtator ndërsa ai dimëror përgatitet dizajni gjatë muajit shtator për t’u implementuar në dhjetor të vitit 2022;
- “Organizime dhe manifestime kulturore”, pjesa teknike dhe artistike, kontrata është në implementim në kohëzgjatje prej dy vitesh;
- “Renovimi i qendrës kulturore në fshatin Llukar”, punët në teren fillojnë në muajin gusht;
- “Renovimi i Amfiteatrit të qytetit”, punët fillojnë në shtator;
- “Furnizim me libra”, në Biblotekën “Hivzi Sylejmani” pritet të dërgohen librat përgjatë muajve shtator/tetor;
- “Konkurs projektimi për renovim infrastrukturor dhe artisik të tunelit të Kurrizit”, përveç përzgjedhjes së fituesit për dizajnim pritet shtesë të organizohet edhe një konsultim publik në muajin shtator.

Ndriçimi, lyerja dhe riparimet në fasadën e Shkollës “Elena Gjika” - Në kuadër të kontratës “Renovimi i Objekteve të Trashëgimisë Kulturore”, pas shumë viteve është bërë lyerja dhe ndriçimi i fasadave të shkollës “Elena Gjika”. Në kuadër të kësaj kontrate, parashihet të bëhet edhe lyerja dhe ndriçimi i fasadave të ndërtesës së Arkivit të Qytetit gjatë muajit shtator.

Restaurimi i Sahat Kullës – Bazuar në Marrëveshjen Bashkëfinancimit në mes Komunës së Prishtinës dhe programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara- UNDP , per restaurimin e Sahat Kullës, ka vazhduar koordinimi mes dy palëve për fillimin e punimeve restauruese në ndërtesë. Punimet restauruese janë duke u zhvilluar sipas planit dhe pritet të përfundojnë në shtator.

Rruga Model – Projekti: Rigjenerimi i rrugës Mehmet Kaqurri “ është iniciuar në vitin 2021 kur edhe kanë filluar punimet. Operatori Ekonomik ka qenë i papërgjegjshëm prandaj edhe është shkëputur kontrata. Është dërguar projekti i reviduar në Institutin e Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve për leje. Në muajin shtator pritet të merret leja dhe të procedohet tutje me procedura të prokurimit për vazhdimin e projektit.

Renovimi i qendrës kulturore në Llukar – janë kryer procedurat e prokurimit. Në gusht pritet të fillon procesi i renovimit. Gjate periudhës Janar – Korrik janë pranuar dhe shqyrtuar gjithsej 377 lëndë:

148

raporte narrative dhe financiare;

62

ankesa për subvencione;

612

kërkesa për pëlqime të aktiviteteve kulturore; dhe

106

kërkesa të ndryshme në fushën e kulturës.

Gjithashtu drejtorja iu është përgjigjur kërkesave të jashtme për plotësim të formularëve dhe dokumentacioneve të kërkuara si:

- UN Women -Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor,
- Agjencinë e Statistikave të Kosovës – anketa për raportin e kostos së punës,
- Performancën Komonale – USAID,
- Planin Gjithëpërfshirëse për përmirësimin e Agjendës evropiane Janar –Qershor 2022.

Në Teatrin e Qytetit të Prishtinës “DODONA “ janë realizuar gjithsej 73 shfaqje të cilat janë shikuar nga 4962 shikues si dhe përveç provave të shumta janë realizuar edhe 6 aktivitete tjera sipas kërkesave përkatëse.

- Janë realizuar në total **65 shfaqje (repriza)** për fëmijë, me gjithsej **4852 shikues**.
- Në skenën për të rritur gjatë kësaj kohe janë realizuar gjithsej **8 shfaqje me gjithsej 110 shikues**.
- Titujt e shfaqjeve në skenën e mbrëmjes që janë realizuar janë:
- “Qyteza e Humbur” 6 repriza dhe “Ditëlindja” 2 repriza.

Teatri “Dodona” ka marr pjesë festivalin e teatrove dhe kukullave në Pogradec, në muajin Qershor.

DREJTORIA E SPORTIT

Drejtoria për Sport, në kuadër të fushëveprimit ka qenë e fokusuar që të vazhdoj të punoj me kapacitetet ekzistuese dhe të parashikuara për zhvillimin e sportit, përmes masivizimit të sportit, riparimin dhe ndërtimin e infrastrukturës sportive, përkrahjen e vazhdueshme të klubeve sportive/shoqatat dhe OJQ, sipas dispozitave ligjore.

Drejtoria, në kuadër të fushëveprimit, mundësive dhe kapaciteteve teknike, financiare dhe resurseve humane ka qenë e përcaktuar që të vazhdoj të realizoj objektiva për arritjen e qëllimeve të përcaktuara si:

- Ngritjen e kapaciteteve infrastrukturore sportive dhe rekreative për klubet sportive dhe komunitetin në Komunën e Prishtinës.
- Mbështetjen e organizatave të ndryshme sportive dhe rinore për realizimin e aktiviteteve të ndryshme me karakter sportiv e rinor;
- Organizimin e aktiviteteve të ndryshme sportive që kanë karakter festiv;
- Organizimin e aktiviteteve të ndryshme sportive që kanë karakter festiv, edukativ dhe sensibilizues;
- Mbështetjen e organizimeve e turneve memorialë;
- Shpërblimin e laureatëve sportiv të Komunës së Prishtinës;

Aktivitetet e zhvilluara nga Drejtoria për Sport në bashkëpunim me klube, Federata dhe OJQ

- Mbi 80 aktivitete të ndryshme sportive të përkrahura nga Drejtoria për Sport;
- Laureatët e vitit 2021;
- FIBA 3x3 Challenger;
- Kampionati botëror universitar në Hendboll;
- Organizimi i aktiviteteve sportive për ditën fëmijëve "1 Qershori";
- Redbull FMX Jam;
- Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe (me Komitetin Olimpik);
- Tournament Prishtina – Futsall 2022;
- Turneu veror në Futboll 2022;
- Festivali i pranverës etj.



Projektet që janë përfunduar gjatë katër muajve janë: Përfundimi i Fitnesit të jashtëm në Gërmi; Përfundimi i Fushës Sportive dhe këndit të lodrave në fshatin Llukar; Përfundimi i Fushës Sportive në fshatin Grashticë; Fillimi i renovimit të shtegut për ecje dhe vrapim në Parkun e Arbërisë; Përfundimi i punëve të një situacioni të tribunës lindore të 2 Korrikut; caktimi i lokacionit për Sallën Multifunksionale në Bernicë; caktimi i lokacionit për fushën e futbollit në Hajvali.



Gjatë kësaj periudhe, janë regjistruar 7 klube të reja; Janë shqyrtuar dhe kthyer përgjigje rreth 200 kërkesa dhe ankesa drejtuar Drejtorisë për Sport; Mbi 50 vizita klubeve, oqj-ve dhe aktiviteteve sportive.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË

Gjatë periudhës 6 mujore Drejtoria e Shëndetësisë ka pranuar 2644 kërkesa për subvencionimin e trajtimeve mjekësore. Stafi në këtë drejtori, kishte takime të përditshme me qytetarë për t'i njoftuar me procedurat dhe me shërbimet sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

6

Gjatë periudhës 6 mujore kemi bërë monitorimin e mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saja si dhe në QMU; Identifikimi i nevojave për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH; dhe Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë.

Filluar nga data Janari 2022, për shkak të kërkesave të shtuara nga qytetarët e Komunës së Prishtinës, Drejtoria e Shëndetësisë në koordinim me komitetin për vaksinim dhe sekretarin permanent të Ministrisë së Shëndetësisë, morrëm vendim mbi zgjatjen e orarit të punës në QMF 7 Kalabri. Në anën tjetër, testimi i qytetarëve me teste Rapide – antigjen, filluar nga data 20.01.22 në Qendrën e studentëve, u realizua 7 ditë të javës me orar 08:00-18:00. Të dy aktivitetet kishin gjatë periudhës raportuese ndryshime në orar pasi ishin të varura nga situata pandemike;

Përgatitje për procedura prokurimi:

- Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve mjekësore QKMF dhe QMU;
- Furnizimi me uniforma për personel shëndetësor; Ndonëse është në proces tek OSHP;
- Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor QKMF dhe QMU dhe
- Servisimi dhe mirëmbajtja e auto veturave për shërbime shëndetësore KPSH;
- Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF dhe QMU dhe
- Furnizim me automjete për nevoja të shërbimeve shëndetësore;
- Deratizimi i garazhave, bodrumeve dhe hapësirave publike dhe rrjetit të kanalizimit;
- Digjitalizimi i Laboratorëve mjekësor;



- Sigurimi Fizik i Objekteve të KPSH-së, duke u bazuar në rekomandimin e zyrës së prokurimit dhe në pritje të miratimit përfundimtar nga ana e Kuvendit Komunal;
- Pranimin e specifikave nga njësia e kërkesës dhe dorëzimin në zyrën e prokurimit të aktiviteti “Blerja e një kabineti të rëntgenografisë/mamografisë;
- Nënshkrimi i Aneks Kontratës të aktiviteti: Ndërtimi i QMF-Veternik;

U inventarizuan me disa artikuj QMF 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 9, dhe 10, Mati Hajvali, Besi dhe AMF ne Bardhosh.

Drejtoria e Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës nënshkroi marrëveshjen: “Grumbullimi, Transportimi dhe Asgjësimi i Mbetjeve Mjekësore” me SHSKUK, ku falë kësaj marrëveshje Komuna e Prishtinës dhe Drejtoria e Shëndetësisë kursejnë 200.000 EUR te buxhetit komunal.

Sfidat kryesore të kesaj periudhe:

- Furnizimi me barna dhe material shpenzues me ankesë në OSHP;
- Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës të objekteve KPSH-së, në pritje të vazhdimin të punimeve sipas pozicioneve të mbetura në kontratën aktive;
- Sigurimi fizik i objekteve shëndetësore me ankesa të vazhdueshme;
- Zhvendosja dhe arkivimi i dokumenteve të mbetura në Komunën e re;
- Furnizimi me Material Shpenzues Mjekësor – në pritje të vendimit të OSHP;
- Furnizimi me Uniforma për QKMF-në – në pritje të vendimit të OSHP ;
- Furnizim emergjent me insulina për nevojat e QKMF-së, OSHP;
- Zgjerimi i Garazheve të QMU-së;
- Digjitalizimi i institucioneve shëndetësore në KPSH;
- Mungesa e punëtorëve në DSH dhe KPSH;
- Mungesa e buxhetit tek subvencionet në raport me numrin e kërkesave të pranuar, për afërsisht priten të shpenzohen 129,430.00€ me kërkesat e miratuara VETEM të muajit Janar;
- Rregullore e subvencioneve jo e adaptuar në buxhet, prandaj rekomandohet ndryshimi apo plotësim i rregullores duke e shkurtuar kohën e pranimit të kërkesave p.sh vetëm 3 muajt e parë të vitit kalendarik apo të fishohet buxheti;
- Mungesa e punëtorëve në DSH dhe KPSH;



Identifikimi i nevojave për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore edhe gjatë gjendjes emergjente si rezultat e pandemisë globale; Identifikimi i nevojave për lehtësimin e punës së përditshme të personelit shëndetësor edhe gjatë gjendjes emergjente si rezultat e pandemisë globale; Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve rreth subvencioneve – shëndetësore.

DREJTORIA E MIRËQENIES SOCIALE

Drejtoria e Mirëqenies Sociale e mbulon përmes sektorit të veçantë, e po ashtu edhe mbi bazën e kompetencave të deleguar mbikëqyrë punën e Qendrës për Punës Sociale. Në këtë drejtim DMS-ja ka realizuar shumë takime me qytetarë të cilët kanë qenë në cilëndo mënyrë palë në procedurat e ndryshme administrative të zhvilluara brenda këtij sektori.

Njëkohësisht është bërë ndarja e subvencioneve të buxhetit për vitin 2022 në shumë prej 800,000€, ku kemi bërë ndarje në disa kategori për subvencionim: me asistencë sociale, persona me aftësi të kufizuara, trajtim mjekësor të moshuar, pagesë qiraje (zgjidhja e çështjes së banimit –strehimit), familje strehuese (fëmijëve të braktisur dhe fëmijë pa përkujdesje prindërorë), fatkeqësitë e ndryshme natyrore, subvencionim për blerje të drunjtëve për raste sociale dhe komunitete, kundër dhunës në familje si dhe OJQ për realizimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale (thirrje publike).

2125

Gjatë këtyre gjashtë muajve të parë kemi pranuar mbi 2125 kërkesa për subvencione për raste të kategorive të ndryshme sociale. Sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës, me nr.14-020/07-0052287/22, të dt.09.03.2022, me të cilin është bërë përcaktimi i përbërjes të Komisionit për shqyrtimin dhe Vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve në fushën e Mirëqenies Sociale. Komisioni i përberë prej 5 anëtarëve profesioniste të fushave përkatëse, duke involvuar këtu edhe shoqërinë civile, QPS-ën si dhe QKMF-së, ka bërë në mënyrë racionale, dhënien e shumës së vlerës së parasë në bazë të kriterëve të caktuara me vendim të rasteve të ndryshme sociale me ç ‘rast u është ofruar shërbimi i mjeteve me pagesë për nevojat e tyre.

Procesi për ndarjen e subvencioneve të kategorive të ndryshme ka kaluar nëpër fazën e shqyrtimit, kontrollimit të dokumentacioneve dhe vlerësimit të kriterëve ku shumica e tyre në bazë të dokumentacionit të ofruar, ku janë mbështetur financiarisht nga



Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave, në shuma të ndryshme në varësi të dokumenteve të prezantuara si vijon:

- Vlerësimi dhe kontrollimi i kartelave sociale në bazë të sistemit të të dhënave për verifikimin e gjendjes së rendë sociale të aplikuesëve nga data baza e QPS-së për kategoritë e rasteve sociale (kontrollimi i kartelave sociale në afate ligjore dhe në kategori e parë (I) dhe të dytë (II)); Verifikimi i Vendimit të personave me aftësi të kufizuara (afati dhe vlefshmëria e Vendimit) të lëshuar nga MPMS; Verifikimi dhe kontrollimi i të gjitha dokumentacioneve për trajtime mjekësore (raporte mjekësore dhe konstatimi i gjendjes së tyre shëndetësore, dëshmitë e shpenzimeve mjekësore); Verifikimi dhe kontrollimi i të gjitha dokumenteve (identifikimi i letërnjoftimit, konfirmimi i kartelës bankare në emër të aplikuesit, vërtetimin e vendbanimit të bashkësisë lokale, si dhe të gjitha dokumentet e përfshira në kërkesë) duke i'u përmbajtur kriterëve në bazë të vendimit të cekur si më lartë;

Lëndë të pranuar dhe të trajtuara në Drejtorinë për Mirëqenie Sociale:

- Ndihmë sociale; 736 lëndë;
- Aftësi e kufizuar; 788 lëndë;
- Të moshuarit; 390 lëndë;
- Subvencionim të qirasë; 33 lëndë;

- Subvencion për OJQ-të; 26 lëndë;
- Thirrja publike; 53 lëndë;
- Kërkesa të ndryshme; 36 lëndë;
- Vendime të kujdestarisë; 32 lëndë;
- Viktimë civile; 7 lëndë;
- Konstatime të rrezikshmërisë së banimit; 7 lëndë;
- Familjet strehuese; 5 lëndë;
- Subvencionimi i nënave lehona, pjesë e SAS: 12 lëndë.

Aktivite e implementuara:

- Riorganizimi i shpërndarjes së shujtes së ngrohtë për familjet në nevojë;
- Ridizajnimi i fondit për fuqizimin e vikativave të dhunës në familje;
- Vendim për përkrahje financiare për lehonat – pjesë e skemës së ndihmës sociale;
- Rekrutimi i 11 punonjëse në Qendrën për Punë Sociale;
- Ngritja e kapaciteteve teknike dhe logjistike në QPS;
- Janë iniciuar fazat e para për ndërtimin e Strehimoreve për LGBTIQ+;
- Kemi iniciuar programin për ofrimin e qasjes komunale për personat me aftësi të kufizuara;
- Kemi iniciuar ngritjen dhe zhvillimin e më tutjeshem të punonjësve të rinj për QPS dhe DMS;
- Kemi hartuar Strategjinë programative dhe të përmirësimit të shërbimeve profesionale sociale dhe familjare të DMS-së dhe QPS-së.
- Kemi iniciuar dhe zhvilluar programe dhe fushata në parandalimin e kërkim-lëmoshës dhe punës së rëndë tek fëmijët;
- Kemi përmbyllur suksesshëm implementimin e projekteve të përkrahura nga DMS-së për ofruesit e shërbimeve (OJQ-ve);
- Kemi hapur thirrjen e re për mbështetje financiare për ofruesit e shërbimeve direkte sociale;
- Kemi hartuar pilot dokumentin për ofrimin e mbështetjes financiare për OJQ-të, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve sociale dhe familjare;
- Kemi përmbyllur procedurat në inventarizimin e Pushimoreve së Banjës së Istogut;
- Kemi bërë shpërndarjen e mijëra pakove ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë;
- Kemi përmirësuar qasjen dhe shërbimin e ofrimit të shujtave të ngrohta ditore për familjet në nevojë;
- Kemi iniciuar renovimin dhe rivitalizimin e Shoqatës Qëndrore të të shurdhërve;
- Është identifikuar lokacioni për ndërtimin e Qendrës së re për Punë sociale;
- Kemi iniciuar procedurat për inventarizimin e 13 qendrave të ndryshme sociale;
- Kemi shpërndarë donacion aparaturë medicinale dhe pajisje të tjera për personat me aftësi të kufizuara;
- Kemi zhvilluar dhjetëra sesione/konferenca/punëtori në lidhje me detyrat dhe ngritjen e kapaciteteve të DMS-së, përfshirë edhe vizita studimore jashtë vendit.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Në kuadër të fushëveprimit në periudhën raportuese për 6 mujorin e parë për vitin 2022, Drejtoria për Planifikim Strategjik është angazhuar në këto aktivitete:

- Përfundimi i lëndëve të ndara në kuadër të drejtorisë, “Informime nga planet”, informime për parcela ndaj kërkesave, kryesisht nga Drejtoria e pronës.
- Informimi i palëve për kriteret e planeve në ditët e caktuara me palë,
- Caktimi i lokacionit për Oden e mjekëve në lagjen Prishtina e Re-Zona Qendër,
- Caktimi dhe përpunimi i materialit për lokacionet e institucioneve parashkollore në lagjet: Kolovica e Re, Kolovica e Vjetër, Mati 1,
- Caktimi i lokacionit të përkohshëm për tregun e lëndëve djegëse,
- Definimi i lokacionit për magazinimin e materialit të azbestit nga Biblioteka Hivzi Sylejmani,
- Sqarime profesionale nga lëmia e planifikimit lidhur me lokacionin e festivalit Sunny Hill,
- Pjesëmarrja në punëtorinë me dt. 02.06.2022 lidhur me Planin e veprimit për qytetin digjital, ku u formuan grupet punuese për shqyrtimin e tri nga veprimet kyçe për këtë plan të cilat janë nxjerrë nga takimet e deritanishme, si dhe është kërkuar të bëhet harmonizim me Planin e qytetit të gjelbër. Gjithashtu është propozuar hartimi i një pyetësori për plotësim nga Drejtoritë sektoriale, për procesin e digjitalizimit.
- Caktimi i lokacionit për ndërtimin e Institucioneve Parashkollore për lagjet Kalabria, Mati 1, Kolovica,
- Përpilimi i raportit të arsyeshmërisë për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e Institucioneve Parashkollore për lagjet Kalabria, Mati1, Kolovicë
- Analizë urbane në bllokun urban “B16” për caktimin e lokacioneve për Odën e Mjekëve dhe Qendrën për punë sociale,
- Mbledhja e informacioneve dhe përgaditja e portfoliove për Project A- Rigjenerimi i Kodrës së Trimave, Project C – Tuneli tek pjesa e vjetër e qytetit, Project D – Tuneli që lidhe lagjen Dardania me Kalabrinë, Project E – Pjesa e vjetër e qytetit, Project F – Unaza e brendshme.
- Ka nisur mbledhja e informacioneve të nevojshme nga Drejtoritë përkatëse për të kompletuar dokumentin që do t’i shërbejë shpalljes së konkursit Ndërkombëtarë për projektin e Muzeut të Artit Modern tek Tulltorja si dhe projektit tek Pallati i Rinisë dhe Sportit.



- Projekti për renovimin dhe inventarizimin e Q.M.F IV është projekt që vazhdon akoma dhe në këtë fazë është bërë përgaditja dhe përzgjedhja e inventarit.
- Mbledhja dhe përpunimi i informatave të kërkuara nga Banka Botërore për disa projekte që lidhen me hapësirat publike.
- Definimi i lokacionit për Liceun Artistik në koordinim me Drejtorinë e Planifikimit.
- Projekti për renovimin e amfiteatrit dhe fushave sportive në Gërmi.
- Përgaditja e termave të referencës për konkursin e projektimit për Liceun Artistik.
- Është dorëzuar dokumenti që do të shërbejë për shpalljen e konkursit Ndërkombëtarë për projektin e Muzeut të Artit Modern tek Tulltorja si dhe projektit tek Pallati i Rinisë dhe Sportit.
- Është përfunduar puna në projektin për renovimin e amfiteatrit dhe fushave sportive në Gërmi.
- Ka filluar puna për projektin rreth riorganizimit të sporteve dhe shtimin e sportelit për personat me aftësi të kufiuara në ndërtesën e Komunës së Re.
- Projektimi i zyrës së mediave në ndërtesën e Komunës së Vjetër.
- Përzgjedhja e dekorit dhe ngjyrave për aktivitetin Akull n'verë.
- Prezantimi grafik i sinjalizimit horizontal për personat me shikim të demtuar, për sportelet në Komunën e re si dhe sportelet në Komunën e vjetër
- Përgaditja dhe printimi i materialeve për takimet me banorët e lagjeve

- Dixhitalizimi i unazës së brendshme dhe rrugës C në sistemin GIS
- Përpunimi i të dhënave ekzistuese të PRRU-ve në sistemin GIS(ne vazhdimesi)
- Dixhitalizimi i sektorit të legalizimit në sistemin GIS (ne vazhdimsi)
- Dixhitalizimi i PRRH “Zona te Fakulteti teknik” (file eshte i korruptuar dhe gjate kesaj jave eshte punuar ne zgjidhjen e ketij problem dhe fillimin e dixhitalizimit)
- Eshte gjetur menyra e lidhjes së databazes ekzistuese të legalizimit në sistemin GIS.
- Dixhitalizimi i rrugës A në sistemin GIS,
- Dixhitalizimi i PRRH “Zona te Fakulteti teknik”
- Përpunimi i të dhënave ekzistuese të PRRU-ve në sistemin GIS(mbishtresimi dhe xhepat),
- Dixhitalizimi i sektorit të legalizimit në sistemin GIS (drejt përfundimit)
- Digjitalizimi i rrugëve me leje në fshatëra
- Përpunimi i rrjetit rrugor të qytetit
- Digjitalizimi i unazës së brendshme (pasi që verzioni i unazës së kaluar nuk ka qenë finali)

GJENDJA EKZISTUESE E KOMUNËS:

- 1.** Institucionet arsimore
- 2.** Institucionet shëndetësore
- 3.** Digjitalizimi i rrjetit rrugor ekzistues
- 4.** Përpunimi i gjendjes ekzistuese të zonës urbane
- 5.** Profili i PZHK-së.

- Përpunimi i fileve nga INS-i i mbishtresimeve dhe xhepave.
- Përpunimi i rrugëve me projekt kryesor : Unaza e brendshme, rruga A, B, C dhe rrjetit rrugor rural të ekzekutuara sipas projekteve kryesore;
- Përgatitja e materialit për takimet me qytetarë : Arbëria 1,2,3 & Shkabaj, Hajvali, Muhaxher&Aktash, Barileve;
- Përgatitja e hartës për Lagjen Kodra e Trimave si pjesë e dokumentacionit për tenderimin e studimit të fizibilitetit për atë zonë;
- Përgatitja e hartës për Lagjen Kolovica si pjesë e dokumentacionit për tenderimin e studimit të fizibilitetit për atë zonë;
- Përgatitja e hartës për Lagjen “ Te hani i Dilit” si pjesë e dokumentacionit për tenderimin e studimit të fizibilitetit për atë zone si rrjedhojë e kërkeses së qytetarëve;
- Digjitalizimi i pronave Komunale për Drejtorinë e Pronës,
- Përpunimi i hartës për Institucionin e policisë;
- Përpunimi i draftit te pjesës tekstuale të PZHK-së – komentet e dyta nga MMPH-ja.

AKTIVITETE TJERA ORGANIZATIVE

- Takime të rregullta me Drejtorinë e Pronës dhe Planifikimit rreth projekteve të ndryshme.
- Takim me Drejtorinë e Shëndetësisë rreth projektit për renovimin dhe inventarizimin e Q.M.F IV.
- Vizitë në teren në pika të ndryshme në Prishtinë me Bankën Botërore dhe superwien për “Livable Pristina Mission”
- Takime me Bankën Botërore dhe Superwien rreth projekteve të ndryshme në Prishtinë.
- Workshop me Bankën Botërore për “Livable Pristina Mission”
- Vizitë në teren në lokacionin e planifikuar për Ndërtimin e Liceun Artistik.
- Takim me Drejtorinë e Kulturës për aktivitetin akull n’verë dhe verë n’dimër
- Takim koordinues me drejtorinë e Urbanizmit për komentet e PZHK-se, për kufijtë e lagjeve që do të shkojnë në rigjenerim ;
- Takim pune me nënkryetaren e KK-se për transformim digjital të Komunës;
- Takim pune me Drejtorinë e pronës për digjitalizim të pronave komunale;
- Takim me Sektorin e rigjenerimit urban për lokacionet e objekteve publike që do të ndërtohen.
- Takim informues rreth studimit të fizibilitetit dhe planit të menaxhimit për Zonën Historike të Prishtinës, ndërmjet UN Habitat, MRKS dhe OJQ-ve,
- Takim i rregullt me task forcën për unazën qendrore,
- Takime të rregullta me Drejtoritë tjera lidhur me koordinimin e aktiviteteve të ndryshme në të cilat Sektori i planifikimit ka dhënë kontribut nga lëmia e planifikimit,
- Takim me zyrtarët e Komunës së Kamenicës dhe zyrtarëve të Komunës së Prishtinës lidhur me definimin e gjurmës për çiklizëm që lidhë këto dy Komuna.
- Takime të rregullta ndërmjet stafit të sektorit për planifikim strategjik dhe sektorëve tjerë Komunal dhe OJQ-ve.

DREJTORIA E KADASTRIT

Drejtoria e Kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa me efikase për qytetarë duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë periudhës shkurt-korrik 2022 janë përfunduar gjithsej **20594** lëndë, nga të dy (2) sektorët - i gjeodezisë dhe kadastrit. Sektori i Kadastrit ka realizuar/përfunduar **5463** lëndë (regjistrim prone, historiate, kërkesa nga institucionet, fshirje/vendosje të bar-rës tatimore, regjistrim/çregjistrim hipoteke, përmirësime, ankesa, plotësime lëndësh), teksa Sektori i Gjeodezisë ka realizuar/përfunduar **1531** lëndë (ndarje parcele, bashkim parcele, përcaktim kufijsh, ri-rregullim kufijsh, identifikim të parcelave ose njërive banesore, pajisje me certifikatë pronësie dhe kopje plani, legalizim).

83.5%

Sa i përket çështjes së lëndëve të legalizimit, sipas Raportit kredibil të USAID-it, e cila është njëkohësisht edhe organizatë monitoruese për komunat - Drejtoria e Kadastrit përgjatë periudhës shkurt-korrik 2022 ka përfunduar 338 vendime për legalizim, me 83.5% të realizimit të punës në përgjithësi.

Drejtoria e Kadastrit, pas rikthimit të normalitetit me gjendjen pandemike në vend, ka caktuar sërish ditët e takimeve me palë, Sektori i Gjeodezisë (ditën e mërkure nga ora 10:00-12:00), kurse Sektori i Kadastrit (ditën e enjte nga ora 10:00-12:00), që nga shkurti 2022.

Në muajin prill është arritur/nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Komunës së Prishtinës mbi sistemin e adresave, ku janë të përfshira në zbatim dy (2) drejtori - Drejtoria e Kadastrit dhe Urbanizmit. Nga korriku Agjencia ka filluar mbajtjen e trajnimeve për zyrtarët që do të punojnë në terren për të finalizuar procesin e sistemit të adresave, pra nga pjesa e dytë e këtij viti ka filluar zbatimi i saj.

IDrejtoria e Kadastrit ka arritur marrëveshje të brendshme me disa institucione sa i

përket çështjes së verifikimit të akteve juridike (kontratave të shitblerjes, aktgjykimeve, aktvendimeve etj), me ç'rast kthimi i përgjigjeve bëhet tashmë në mënyrë elektronike zyrtare, gjithashtu edhe kërkesa për verifikim nga ana e Kadastrit, duke ekonomizuar procedurën, shkurtuar kohën e kërkesës dhe përgjigjes. Të tilla marrëveshje janë arritur me Gjykatën Themelore Prishtinë dhe Arkivin Komunal, teksa po shqyrtohet mundësia që kjo formë e bashkëpunimit të realizohet edhe me Ndërmarrjen Publike Banesore, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Odën e Noterëve (e cila pjesërisht zbatohet).



Është përgatitur Udhëzuesi për qytetarë rreth çështjes së regjistrimit të pronës, mënyrat e regjistrimit, dokumentet e nevojshme si dhe sqarimet tjera ligjore të nevojshme për tu ditur, i cili bashkë me Raportet e punës së Drejtorisë është publik në faqen prishtinaonline.com – duke respektuar kështu edhe parimin e transparencës dhe komunikimit me publikun.

Bashkë me Drejtorinë e Administratës është realizuar projekti i rregullimit-shtimit të nëntëmbëdhjetë (19) zyrave pritëse të reja, një (1) prej tyre është paraparë të shërbejë për personat me nevoja të veçanta, dhjetë (10) do të shërbejnë për shërbime gjeodezike dhe kadastrale, pjesa tjetër për tatimin në pronë.

Funksionalizimi i tyre pritët të bëhet në fund të muajit shtator, më së largu në fillim të tetorit. Të gjitha shërbimet centralizohen në një vend, çka nënkupton se palët/qytetarët nuk kanë nevojë që për një shërbim të shkojnë në të dy objektet e komunës, por vetëm njërin.

Gjithashtu, Drejtorja e Kadastrit ka plotësuar kërkesat e Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës – Rajoni i Prishtinës, duke e veçuar një zyre pritëse vetëm për shërbimet gjeodezike, të cilat kryesisht i kryejnë gjeodetët e licencuar si të autorizuar në emër të palës si dhe duke ua dërguar tashmë aktvendimet që nxjerr sektori i gjeodezisë përmes komunikimit elektronik zyrtar, proces që deri më tani ka ngecur ose nuk është kryer plotësisht.

Nga aspekti i burimeve njerëzore drejtorja ka nevojë të jashtëzakonshme për staf, për çka janë iniciuar procedurat rekrutuese, duke u aprovuar dhjetë (10) pozita pune – pesë (5) prej tyre në sektorin e gjeodezisë dhe pesë (5) tjera në sektorin e kadastrit. Tashmë jemi në fazën e rekrutimit dhe deri në fund të tetorit pritët të përmbyllen të gjitha, gjegjësisht të rekrutohen zyrtarët për pozitat e kërkuara, çka e lehtëson tejmas punën e

drejtorisë, duke rritur efikasitetin dhe duke e kthyer shërbimin ndaj qytetarëve në nivelin më të kënaqshëm.

Përtej këtyre çështjeve të përfunduara, Drejtoria e Kadastrit në proces-inicim ka çështjen e digjitalizimit të shërbimeve, për çka që nga muaji mars 2022 është në kontakt e bashkëpunim të vazhdueshëm me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), që të finalizohen modalitetet e nxjerrjes ONLINE të certifikatës së pronës fillimisht, e pastaj edhe të kopjes së planit (nëse është e mundshme), dhe si afat është përcaktuar muaji tetor, pra lansimi i shërbimit online për nxjerrje të certifikatës së pronësisë.

Për vitin 2022, Drejtoria e Kadastrit nuk ka pasur të projektuar investime/projekte kapitale, teksa edhe për vitin 2023 – pas konsultimit me Agjencinë Kadastrale të Kosovës nuk është projektuar buxhet për ndonjë investim kapital, pasi që nga ky aspekt është menduar strategjikisht, sepse Drejtoria e Kadastrit në fakt funksionon edhe si Zyre Kadastrale Komunale (me kompetenca të deleguara edhe sipas nenit 15 paragrafi 15.2 nën a), dhe meqë është në proces Projektligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, i cili ndër tjerash parasheh edhe organizimin e ZKK-ve brenda AKK-së, pra centralizimin apo funksionimin vertikal, atëherë nuk është vendosur për iniciimin e ndonjë projekti kapital, pa u shqyrtuar çështja e organizimit.

Përtej kësaj, AKK ka paraparë që në vitin 2023 të fillojë me digjitalizim të shërbimeve (të regjistrimit të pronës, shërbimeve gjeodezike – ndarje, bashkim, përcaktim kufiri etj), por që edhe këtu është i imponuar veprimi/procedimi me kalimin e projektligjit të lartcekur.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Gjatë periudhës raportuese ky sektor ka organizuar bashkëpunim të mirë të Komunës dhe qytetarëve të bashkësive lokale në identifikimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme, kryesisht nga lëmi i infrastrukturës. Zyrat e bashkësive lokale kanë kryer shërbime administrative të ndryshme, ku sipas kërkesave të palëve janë lëshuar rreth 11000 vërtetime për rregullimin e dokumentacionit personal, të drejtave në asistencë sociale, të drejtave të qytetarëve që përkohësisht jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme.

Në cilësinë e menaxherit është bërë mbikëqyrja e realizimit të kontratës së shërbimit të pastrimit në të gjitha objektet Komunale, po ashtu është bërë mbikëqyrja e zbatimit të kontratës për furnizim me material higjienik të objekteve të kulturës dhe bashkësive lokale në fshatra.

Është bërë aktivizimi i Bashkësisë Lokale në Tophane. Sektori i bashkësive lokale ka ofruar shërbime edhe për drejtoritë tjera në kuadër të Komunës. Kemi mbajtur takime të shumta individuale me kryetarët e bashkësive lokale.

PUNA E KUVENDIT KOMUNAL

Gjatë periudhës janar – qershor 2022, janë mbajtur gjithësejt 10 (dhjetë) mbledhje prej tyre: 5 (pesë) mbledhje të rregullta, 1 (një) mbledhje e jashtëzakonshme dhe 4 (katër) mbledhje solemne. Janë mbajtur 5 (pesë) mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa, 3 (tri) mbledhje të Komitetit për Komunitete, 3 (tri) mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Komiteti Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara ka mbajtur 4 (katër) mbledhje.

Numri i vendimeve të miratuara në Kuvendin e Kryeqytetit gjatë kësaj periudhe janar – qershor 2022 është 37 (tridhjetë e shtatë) vendime. Gjithashtu, Kuvendi i Kryeqytetit gjatë kësaj periudhe ka mbajtur gjithësejt 8 (tetë) takime publike me qytetar.

Sektori për punë të Kuvendit ka kryer edhe këto punë dhe shërbime: ftesat, njoftimin e anëtarëve, përgatitjen e materialeve, pranimin e materialeve nga drejtoritë e ndryshme, transkriptet dhe ekstraktet e procesverbaleve, përgatitja e propozimvendimeve të ndryshme për pikat e rendit të ditës, incizimi, menagjimi dhe mirëmbajtja e

sistemit elektronik, lekturimi dhe përkthimi në gjuhën serbe i materialeve të ndryshme të Kuvendit dhe të gjitha drejtorive, kompletimin dhe dërgimin e materialve në MAPL për të gjitha këto mbledhje të mbajtura deri më tani. Së bashku dhe në koordinim dhe ekzekutivin e Komunës, me kryesuesin e Kuvendit janë kryer edhe punë të tjera të cilat kanë të bëjnë me Sektorin e Kuvendit.

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2022, Sektori për Teknologji Informative, ka kryer këto punë dhe ka afruar ofruar këto shërbime për administratën e komunës, Shkollat, Çerdhet, Bashkësitë Lokale, Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendrat e Mjekësisë Familjare, Qendrën e Mjekësisë Urgjente, Qendrat për Punës Sociale, Brigadën e Zjarfikëseve si vijon më poshtë:

Kemi kryer shërbime softuerike dhe harduerike, për administratën komunale dhe institucionet tjera të komunës:

- instalimi dhe konfigurimi i sistemeve operative, programeve aplikative,
- instalimi dhe konfigurimi i kompjuterëve për operim funksional në rrjetë,
- instalimi dhe konfigurimi i printerëve, fotokopjeve, ploterëve, digjital senderëve etj,
- identifikimi dhe zgjidhja e problemit të sistemit operativ dhe programeve aplikative,
- identifikimi dhe zgjidhja e problemeve harduerike,
- identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në rrjetin lokal (LAN)

Jemi kujdesur për siguri në teknologji informative, në rrjeta, aparate, sisteme dhe programe të cilat punojnë dhe ruajnë të dhëna të ndryshme. Kemi bërë kopjet (backup) ruajtjen e të dhënave të rëndësishme nga bazat e të dhënave të ndryshme që kemi në komunë. Kemi mirëmbajtur Serverët e komunës së Prishtinës. Kemi bërë mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrjetit LAN dhe sipas nevojës kemi bërë kyçjen e kablllove në kabine, switch-a, dhe përcaktimi i porteve. Kemi vazhduar krijimin e llogarive në e-mail-in zyrtar për stafin e komunës, në bashkëpunim me Agjencinë për Shoqëri të Informacionit (ASHI). Kemi mirëmbajtur e-kiosqet e komunës së Prishtinës. Kemi mirëmbajtur sistemin e menaxhimit të radhës. Kemi bërë monitorimin e mbledhjeve të KK. Prishtinë përmes teleprezencës. Përditësimi i informatave në web faqen zyrtare dhe Prishtina Online, dhe publikimi i atyre informatave në gjuhë zyrtare. Krijimi i userave në Intranet për stafin e ri të Gjendjes Civile, Publikimi i biografive të drejtorave në gjuhën shqipe dhe serbe, si dhe kontaktet e secilës drejtori&asistentëve/eve dhe Publikimi i pyetjeve të shpeshta të qytetarëve për Drejtorinë e Kadastrit.

Kemi menaxhuar/administruar këtë projekte/sisteme:

- Menaxhimi dhe administrimi i sistemit të brendshëm Intranetit
- Mirëmbajtja e uebfaqes zyrtare të komunës së Prishtinës dhe PrishtinaOnline,
- Komunikimi online me qytetare nëpërmjet Prishtina Online,



- Publikimi i të të hyrave dhe shpenzimeve në Prishtina Open Data
- Mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit të mbeturinave,
- Platforma digjitale për participim publik.

Kemi menaxhuar dhe mbikëqyrur këto kontrata:

- Kontratën e AQP-së “Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera”;
- Furnizimi me toner për nevojat e komunës së Prishtinës;
- Mirëmbajtja i sistemit të menaxhimit elektronik të automjeteve me pajisje GPS;
- Mirëmbajtja e e-kiosqeve;
- Mirëmbajtja, servisimi i pajisjeve të TI-së, furnizimi dhe montimi me pjesë rezervë;
- Mirëmbajtja e platformës Prishtina Online;

Kemi iniciuar këto projekte:

- Projekti “Digjitalizimi i shërbimeve dhe proceseve të punës;
- Projekti “Furnizimi me kamera për komunë të vjetër dhe të re;
- Projekti “Furnizimi me pajisje të TI-së për nevojat e komunës”.

Për kryerjen e punëve dhe obligimeve të punës, për realizimin e saj sa më efikas dhe azhure në punë, Sektori Teknik ka punar në bazë të planit dhe programit të punës. Ky

plan i punës përfshinë: Objektin e vjetër të KK, objektin e ri të KK, Drejtorinë e Inspeksionit, 31 Bashkësi Lokale, 8 zyre të vendit, dhe disa zyre e lokacione të tjera.

- Sigurimi dhe mirëmbajtja e objekteve të Komunës,
- Mirëmbajtja e pajisjeve në sallën e Kuvendit të Komunës,
- Mirëmbajtja e ngrohjes qendrore,
- Kryerja e punëve teknike rreth regjistrimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të Komunës,
- Mbikëqyrja për mënyrën e shfrytëzimit të automjeteve të Komunës,
- Renovimi i 15 zyreve tek objekti i Komunës së vjetër në llyerje dhe shtruarjen me laminat,
- Rifunksionalizimi i Bashkësis Lokale në Hajvali,
- Rifunksionalizimi i Bashkësis Lokale në Tophane,
- Renovimi i Depos- Komuna e Vjetër,
- Llyerja e katit përdhes – Komuna e vjetër,
- Përfundimi i Vendimi për përdorimin e automjeteve zyrtare.
- Përfundimi i tenderin për pastrim.
- Përfundimi dhe demolimi I kontenjerëve nga ish Akp-ja.
- Rregullimi i sistemit të klimatizimit në Komuna e Re në Arbëri.
- Rifunksionalizimi I banjos për personat me aftësi të kufizuar – Komuna e vjetër.
- Krijimi i sporteve Komuna e re Arbëri,
- Ndërrimi i tepisonit tek Oda- Kabineti i Kryetarit,
- Vendosja e foljeve të akullta në dritare tek pjesa e krijimeve të sporteve të reja Komuna e re,
- Përfundimi i Vendimit për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare,
- Përfundimi i tenderit për pastrim,
- Rregullimi dhe dërgimi i gjeneratorit tek Drejtoria e Inspeksionit,
- Përfundimi i tenderit për material shpenzues për zyre,
- Përfundimi i dy kontratave për renovimin e bashkësive lokale dhe Administratës,
- Vendosja e aparateve për tharjen e duarve kati përdhes – Komuna e vjetër
- Vendosja e klimave tek zyret e reja – Komuna e re,

DREJTORIA E PARQEVE

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2022 kjo drejtori është angazhuar në konsolidimin e e sektoreve të saj si dhe identifikimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme si dhe krijimin e hapsirave dhe koridoreve të gjelbërta në territorin e Komunës së Prishtinës.

Në periudhën Janar – Qershor janë pranuar mbi 100 lëndë nga qytetarët dhe institucionet tjera për shfrytëzim të hapsirës për mbajtjen e aktiviteteve të ndryshme, krijimin e hapsirave të reja gjelbëruese, mbjelljen e drunjëve, shkurreve dhe luleve sezonale, krasitja, ujitja si dhe mirëmbajtja dhe trajtimi i tyre. Gjatë kësaj periudhe kohore janë kryer punë në kuadër të aktiviteteve të punës të cilat i kryen NPL "Hortikultura" sh.a në Prishtinë.

Ju paraqesim në mënyrë tabelare disa nga këto aktivitete punuese:

- Evidentimi dhe planifikimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapsirave të reja të gjelbërta dhe rekreative në kryeqytet;
- Konceptimi dhe projektimi i Parkut linear të lagjja e Spitalit, në Mat, Arbëri si dhe xhepeve urban në zonën urbane
- Planifikimi dhe mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapsirave të gjelbëruara në qytet së bashku me NPL "Hortikultura", krasitja dhe prerja e drunjëve sezonal dhe atyre që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre dhe punë të tjera të mirëmbajtjes dhe pastrimit të hapsirave të gjelbërta;
- Diskutim publik me banorët e Bllokut të I-rë për trajtimin e hapsirës publike;

Regjenerimi dhe rekultivimi i hapsirave të sipërfaqeve të gjelbërta me drunjë, shkurre dhe lule dekoruese:

- Regjenerimi i ishullit përgjatë Rr. "Eqrem Çabej";
- Rikultivimi i hapsirave gjelbëruese përgjatë Rr. "Bill Clinton";
- Regjenerimi i ishullit përgjatë Rr. "Arbnor dhe Astrit Dehari";
- Regjenerimi i hapsirave gjelbëruese përgjatë Rr. "Tirana";
- Regjenerimi dhe popullimi i hapsirave të gjelbërta në Parkun e Qytetit;
- Regjenerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe krijimi koridorit të gjelbërt tek Shkallët e Arbërisë;



- Rikultivimi i hapsirës gjelbëruese te stacioni policor në Rr.Luan Haradinaj;
- Rikultivimi i sipërfaqeve të gjelbërta përgjatë Rr.Xhorxh Bush;
- Pyllëzimi me fidane në fshatin Butovc;
- Regjenerimi i hapsirës gjelbëruese afër rreth rrotullimit te Rr.Muharrem Fejza;
- Regjenerimi i ishujve përgjatë Rr.“Muharrem Fejza”;
- Rikultivimi i Ishullit përgjatë Rr.“Dëshmorët e Kombit”;
- Regjenerimi i sipërfaqeve të gjelbërta përreth Shkallëve të Arbërisë;
- Rikultivimi i hapsirës gjelbëruese në Rr. Enver Maloku
- Rikultivimi i hapsirës gjelbëruese në Ulpianë
- Rikultivimi i hapsirës gjelbëruese në Sheshin e Qytetit
- Rikultivimi i hapsirës gjelbëruese në SOS fshatin
- Regjenerim i sipërfaqeve në parkun e Lagjes Lakrishte
- Rikultivimi i hapsirave gjelbëruese përgjatë Rr.Fehmi Agani dhe hapsirat e gjelbërta në mes blloqeve të banimit
- Rikultivimi i hapsirave gjelbëruese përgjatë Rr. Luan Haradinaj
- Regjenerimi i hapsirës gjelbëruese mbi Pllaton e Pallatit të Rinisë
- Regjenerim i sipërfaqes përreth Stadionit Fadil Vokrri
- Rikultivimi i sipërfaqes gjelbëruese përgjatë Rr.Agim Ramadani
- Rikultivimi i sipërfaqes gjelbëruese dhe ishulli përgjatë Rr.Fehmi Lladrovci

- Regjenerim i sipërfaqeve gjelbëruese në afërsi të muzeut etnografik Emin Gjikut
- Rregullimi i sipërfaqeve gjelbëruese përgjatë Rr.Nazim Gafurri
- Rikultivimi i sipërfaqes gjelbëruese në oborrin e Biblotekës Hivzi Sylejmani
- Rikultivimi i sipërfaqes gjelbëruese te Stacioni Policor në Rr.Hamez Jashari
- Rikultivimi i sipërfaqes gjelbëruese në Rr.Hyzri Talla
- Regjenerimi i hapsirave gjelbëruese i Qendrave të Bashkësive Lokale në Tophane, Hajvali, Sofali
- Implementimi i Xhepit urban në Aktash
- Implementimi i Xhepit urban në kryqëzimin e rrugëve Uçk dhe Fehmi Agani
- Implementimi i Xhepit urban në Rr.Agim Ramadani
- Implementimi i Xhepit urban prapa shkollës fillore “Elena Gjika”
- Regjenerimi me shkurre dekoruese dhe drunj në parqe si: Parku i Qytetit, Parku i Dardanisë dhe Parku i Taukbashqes.

Pjesëmarrja në programin tetë mujor të udhëheqjes virtuale për dizajnimin e qyteteve, workshop nga GDCI (Iniciativa Globale për Projektimin e Qyteteve).

Shtrirja e sistemit të ujitjes përgjatë shkallëve të Arbërisë, në hapsirën e gjelbërt përreth ndërtesës së Komunës së re në hapsirat e çerdhës Shkronjat, parkun Adem Demaçi, hapja e tre puseve (340m) dhe shtrirja e 10,013m system i ri i ujitjes në shkolla, çerdhe,parqe dhe hapsira publike;

- Inicimi për procedurat e tenderimit i kontratës për mirembajtjen dhe meremetimin e këndeve të lodrave në Komunën e Prishtinës
- Inicimi për procedurat e tenderimit për kontratën për shtrirje të sistemit të ujitjes dhe hapjen e puseve në hapësirat të gjelbëta në Komunën e Prishtinës
- Organizimi dhe koordinimi i planeve operacionale të gjelbërimit për periudhën raportuese Janar – Qershor 2022
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapsirave të parqeve për aktivitete kulturore dhe promovimin e mjedisit;(Parku I qytetit).
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e Qendrës Rekreative “Gërmia” për aktivitete sensibilizuese dhe edukuese, kulture,sport dhe mjedis;
- Pranimi i kerkesave dhe ankesave nga qytetarët,shqyrtimi i tyre edhe nga subjektet tjera komunale dhe dërgimi i tyre për personin apo subjektin që i dedikohen;

DREJTORIA E ARSIMIT

Gjatë gjshtë mujorit të parë të vitit është dërguar në MASHT lokacioni dhe projekt-
ti ideor për ndërtimin e një çerdheje në Kolovicë. Kemi tenderuar projektin për
ndërtimin e tri shkollave të reja në lagjet Sofalia, Mati 1, Veternik. Kemi dërguar lokacioni
për ndërtimin e shkollës së re fillore në Veternik, dhe projekti ideor po përgatitet që të
dorëzohet për financim në MASHT.

Ka filluar procesi i pajisjes me akt të themelimit të shkollës së mesme profesionale të
TIK në Prishtinë, në bashkëpunim me Lux Dev. Mësimi në këtë shkollë do të fillojë me 1
shtator 2023.

Janë votuar në asamble 3 propozime për lokacione për ndërtime të çerdheve dhe
adaptim të hapësirave ekzistuese; Ka filluar zhbllokimi i projektit për ndërtim të shkollës
së re në lagjen Arbëria, projekt që ka stagnuar për vite me radhë; Në proces ndërtimi i
aneksit të shkollës Pavarësia si dhe ndërtimi i çerdhes Xixëllonjat.

AMBIENTE TË SIGURTA MIQËSORE NË SHKOLLA

Kemi filluar hartimin e planit të veprimit për siguri në shkolla, në bashkëpunim me Po-
licinë e Kosocës dhe Universitetin e Prishtinës- Dega e Psikologjisë. Kemi bërë renovimi
i tërësishëm i shkollës fillore Iliria dhe shkollës fillore Pjetër Bogdani.

22

Renovime në 22 shkolla fillore dhe të mesme, renovime në të gjitha çerdhet publike. Fillimi i projektit “asnjë shkollë në terr”, ku do të ndriçohen ambientet shkollore në çdo çerdhe dhe shkollë të Prishtinës.

Ndërtimi i tre fushave të reja sportive në shkollën Hilmi Rakovica. Ka filluar procesi për
ndërtimin e sallës të edukates fizike të shkollës fillore Gjegj Fishta. Kemi bere furnizmin
me kamera të sigurisë nëpër shkolla. Kemi derguar per tenderim blerjen e dollapëve
individual për nxënësit e klasave 1-5; Aparat dezinfektues për enët dhe paisjet ushqij-



more për të gjitha çerdhet publike dhe me bazë në komunitet të Prishtinës, donacion nga Neptun Kosova; Panele solare në shkollën Iliria dhe Model, donacion nga KFOS.

CILËSI NË ARSIM

- Trajnimi i 70 edukatoreve në nivelin parafillor në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit dhe UNICEF;
- Furnizime me kabinete të lëndëve shkencore për të gjitha shkollat fillore dhe të mesme me shkak të konkretizimit të lëndëve mësimorë;
- Furnizim me pajisje pune për të gjitha shkollat profesionale;
- Furnizim me kompjuterë, laptopë dhe tabela digjitale;
- Punësimi i 15 asistentëve për fëmijë me nevoja të vecanta;
- Zgjerimi i projektit për lexim-kuptim në 6 shkolla të reja, ku nxënësit e klasëve 1-5 do të kenë literature të re për të zgjeruar njohuritë e tyre në lexim-kuptim;
- Mësimi zgjedhor për herë të parë i realizuar me konkurs të jashtëm ku janë përzgjedhë projektet më të mira për fëmijët. Lëndë të reja për kodim, yoga, matematikë aplikative, orientim në karrierë etj.

PROJEKTE TJERA

- Janë ndarë 120 bursa për studentët më të dalluar të Prishtinës në universitetet publike
- Ka filluar procesi i rekrutimit të drejtorëve dhe zëvenadës drejtorëve të shkollave dhe çerdheve në bashkëpunim me Ambasadën Britanike
- Themelimi Eco-klubeve në çdo shkollë të mesme të Prishtinës në bashkëpunim me Caritasin. Nxënësit dhe arsimtarët do të trajnohen për mbrojtjen e mjedisit dhe do të aftësohen për përgatitje të projekt-propozimeve. Secili klub i shkollës do të realizojë projekt të gjelbër për shkollën në vlerë prej 5,000 Euro.
- Është themeluar Task Forca e brendshme në bashkëpunim me LuxDev për ndërlidhjen e proceseve arsimore me nevojat e tregut të punës. Për më tepër është themeluar UPCO Cluster, iniciativa e parë triple-helix në Kosovë në mes të Universitetit të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe Komunës së Prishtinës. Me përcaktimin e bordit, qendra ka filluar punën dhe aktivitetet për qëllim kryesor kanë zvogëlimin e hapësirës në mes të edukimit dhe tregut të punës.
- Gjatë periudhës janar-qershor 2022 është themeluar një grup punues për të evidencuar numrin e nxënësëve (sipas shkollave dhe klasëve), numrin e mësimeve si dhe profilet e shkollave në Prishtinë. Pas kësaj pritët të dilet me rekomandime për hapat tutje. Komuna e Prishtinës është e përfaqësuar edhe në grupin punues të MASHT që ka për qëllim analizimin dhe hartimin e politikave të nevojshme që do të mundësojnë ristrukturimin e rrjetit ekzistues shkollor.
- Drejtimi për Teknologji Informative dhe të komunikimit në shkollën "Gjin Gazulli" është zgjeruar dhe përfshinë drejtime të reja, që brenda kanë edhe kodimin. Drejtimet e reja janë: Teknik i Sistemeve të Informatikës, Zhvillues i Aplikacionit dhe Teknik i Informatikës. Stafi profesional i shkollës është trajnuar që të fillojë zbatimin e këtyre drejtimeve. Gjithashtu me kërkesën tonë në kuadër të bashkëpunimit me LuxDevin drejtimi i Kodimit Programimit pritët të jetë njëri ndër drejtimet kryesore të shkollës së re profesionale të TIK-ut në Prishtinë.
- Në SHML "7 Shtatori" për herë të parë në vitin shkollor 2022/2023 priten drejtimet e reja si Asistent për Turizëm, Asistent për Hotelieri dhe Asistent për Tregti. Pra, pika si Asistent për Turizëm parasheh edhe Guidën Turistike;
- Trajnimi i 70 edukatoreve në nivelin parafillor në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit dhe UNICEF
- Furnizime me kabinete të lëndëve shkencore për të gjitha shkollat fillore dhe të mesme me shkak të konkretizimit të lëndëve mësimorë
- Furnizim me pajisje pune për të gjitha shkollat profesionale
- Furnizim me kompjuterë, laptopë dhe tabela digjitale

- Punësimi i 15 asistentëve për fëmijë me nevoja të vecanta
- Zgjerimi i projektit për lexim-kuptim në 6 shkolla të reja, ku nxënësit e klasëve 1-5 do të kenë literature të re për të zgjeruar njohuritë e tyre në lexim-kuptim
- Mësimi zgjedhor për herë të parë i realizuar me konkurs të jashtëm ku janë përzgjedhë projektet më të mira për fëmijët. Lëndë të reja për kodim, yoga, matematikë aplikative, orientim në karrierë etj.
- Ka filluar hartimi i planit të veprimit për siguri në shkolla, në bashkëpunim me Policinë e Kosocës dhe Universitetin e Prishtinës- Dega e Psikologjisë
- Renovime në 22 shkolla fillore dhe të mesme, renovime në të gjitha çerdhet publike
- Fillimi i projektit “ASNJë SHKOLLë Në TERR”, ku do të ndriçohen ambientet shkollore në çdo cerdhe dhe shkollë të Prishtinës
- Ndërtimi i tre fushave të reja sportive në shkollën Hilmi Rakovica
- Ka filluar procesi për ndërtimin e sallës të edukates fizike të shkollës fillore Gjegj Fishta
- Furnizimi me kamera të sigurisë nëpër shkolla
- Tenderimi i dollapëve individual për nxënësit e kalsëve 1-5

DREJTORIA E PRONAVE

Ndër aktivitetet kryesore të 6 mujorit janë:

- Publikimi i listës së Përgjithshme të Pronave të Paluajtshme komunale në faqen zyrtare: Prishtina Online – Prona.
- Miratimi i Listës së Veçantë të Pronave të Paluajtshme Komunale të cilat mund të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2022.
- Formimi i grupit punues për verifikimin e statusit të pronave komunale.
- Vendim për lirim të hapësirave publike në parkun e Tauk Bashqes dhe hapësirën afër QKUK-së.
- Dhënia në shfrytëzim e pronës komunale për AVUK.
- Vendim për dhënien në shfrytëzim së pronës së paluajtshme të Komunës për Operatorin, Sistemin, Transmisionin dhe Tregu “KOSTT” SH.A.
- Është themeluar Komisioni për hartimin e Rregullores për dhënie me qera deri në 1 vit, të pronave komunale.
- Është themeluar Komisioni për shitjen e të drejtave banesore.
- Është bërë riidentifikimi i pronave komunale në Zonën Industriale dhe i banesave në Bregun e Diellit, Fushë Kosovë, Fushën e Pajtitimit dhe në Hajvali.

Raporti për kontratat e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale për Kryetarin e Komunës.

- Vazhdimi i verifikimit të statusit të pronave si dhe mundësia e shtimit të stafit që do të merren vetëm me këtë proces.
- Kryetari i Kryeqytetit ka themeluar 3 Komisione te veçanta për vlerësimin e shfrytëzimit të pronës komunale në këto zona, në bazë të gjetjeve të ZKA.Poashtu po verifikohen të gjitha kontratat e shfrytëzimit nga Komisioni i themeluar.

Në Drejtorinë e Pronës në Prishtinë gjatë periudhës **Janar-Gusht 2022** janë pranuar 410 kërkesa të ndryshme prej të cilave:

- Në sektorin për pronësim, shpronësim dhe kembim janë përpunuar gjithsej 186 kërkesa ;

Totali i kërkesave të pranuarra për këtë sektor ka qenë kërkesa nga të cilat 111 kërkesa janë aprovuar dhe 75 kërkesë ka ngelur në procedurë.

- Në sektorin për pronë janë përpunuar gjithsej 224 kërkesa;

Totali i kërkesave të pranuarra për këtë sektor ka qenë kërkesa nga të cilat 120 kërkesa janë aprovuar dhe 104 kërkesë ka ngelur në procedurë.

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Ndër aktivitetet kryesore të 6 mujorit janë:

- Ka filluar procesi i rekrutimit të inspektorëve të rinj (konkursi në proces). Si fazë e parë janë shpallur gjithsej: 8 (tëtë) inspektorë të shërbimeve publike (rendit komunal), 4 (katër) inspektorë të ndërtimit dhe 3 (tre) zyrtarë tek sektori i pyjeve.
- Derisa kërkesat janë gati të diagnostifikuara për një sistem që lejon përcjelljen e statusit të një ankese/kërkesë me numër, jemi në proces të gjetjes së fondeve për mbulimin e shpenzimeve me partnerë të rinj që kanë fokus përmirësimit dhe komunikimit dhe transparencës me qytetarë. Në ndërkohë ka filluar trajtimi i ankesave nëpërmjet rrjetëve sociale deri në krijimin e një platforme të mirëfilltë digjitale për pranimin e ankesave/kërkesave nga qytetarët. Kjo metodë e komunikimit me qytetarët nëpërmjet rrjeteve sociale ka mundësuar që të arrijmë të trajtojmë rreth 50 kërkesa në javë duke mos i përfshirë ato që pranojmë nëpërmjet emailit zyrtar dhe thirrjeve.



- Kemi intervenuar në oborrin e shkollës “Emin Duraku” për të rrënuar një objekt të vjetër e të dëmtuar i cili në të kaluarën ka shërbyer për vendosjen e rezervuarëve të derivateve për ngrohje e i cili është vlerësuar me rrezikshmëri për nxënësit dhe punonjësit e kësaj shkolle.

- Po vazhdon largimi i reklamava të vendosura vend e pavend kudo në hapësira publike të kryeqytetit dhe pa leje të organeve kompetente komunale.
- Së bashku me Policinë e Kosovës po zhvillojmë aksione të përbashkëta për të inspektuar respektimin e orarit të muzikës dhe orarit të punës nga ana e bizneseve të gastronomisë në Kryeqytet.
- Hapësirat e liruar në Pallatin e Rinisë, tani janë shndërruar në hapësira të bukura për argëtim dhe rekreacion të fëmijëve.
- Po vazhdojmë aksionet kundër shitësve ambulantë, të cilët përveç uzurpimit të hapësirave publike, rrezikojnë edhe shëndetin e qytetarëve të Prishtinës duke shitur produkte ushqimore në kushte absolutisht të papërshtatshme higjienike.
- Kemi larguar të gjithë shitësit nga rrugët në afërsi të “Tregut të Gjelbërt” dhe njëkohësisht kemi organizuar pastrimin e këtyre rrugëve nga mbeturinat e shumta të grum-



bulluara aty ndër vite. Falemderojmë të gjithë shitësit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e treguar gjatë këtij aksioni i cili ka për qëllim transformimin e Prishtinës!

- Drejtoria e Inspeksionit në kuadër të Planit të Veprimit po vazhdon aksionin kundër taksistëve ilegal të cilët përveç problemeve që i shkaktojnë trafikut të Prishtinës përbëjnë edhe rrezik për udhëtarët të cilët shfrytëzojnë të njëjtit!
- Drejtoria e Inspeksionit me mbështetje edhe të “Hortikulturës” dhe “NPB” po vazhdon aksionin për lirimin e rrugës, trotuareve dhe hapësirave të tjera në një pjesë të Rrugës Bajram Bahtiri, konkretisht në zonën afër Shkollës Nazim Gafurri dhe Qendrës Komunale të Mjeksisë Familjare. Deri vonë këto hapësira janë keqshfrytëzuar kryesisht nga shitësit e drunjëve duke bllokuar me mjetet e tyre rrugën dhe trotualet gjë që ka vështirësuar jashtë mase qarkullimin e këmbësorëve por edhe trafikut në këtë rrugë.
- Pas ndërhyrjes së Drejtorisë së Inspeksionit, rruga “2 Korriku” e gatshme për festën e madhe të 2 Korrikut.
- Bashkë me përfaqësues të Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina” sh.a. vizituar objektin – pompën jofunksionale të derivateve në fshatin Mramor e cila përbënë rrezikshmëri të lartë për ambientin. Përveç tjerash, në objektin në fjalë inspektorët e Komunës së Prishtinës kanë hasur edhe në rezervarë për të cilët dyshohej se ka akoma mbetjet e derivateve. Pas inspektimit të drejtpërdrejtë të këtij lokacioni dhe

të objektit, Drejtoria e Inspekcioneve ka marrë masa mbrojtëse duke e ndaluar hyrjen e personave të paautorizuar në atë lokacion që përbënë rrezik të lartë deri në një vendim tjetër të organeve kompetente komunale.

- Në kuadër të aksionit për lirim dhe hapësirave publike, kemi liru hapësirën – parkingun i cili gjendet pranë Kino Rinisë i cili për vite me radhë ka qenë i uzurpuar dhe duke u keqpërdorur nga persona të papërgjegjshëm të cilët qytetarëve të Prishtinës iu kanë marrë të holla në këmbim të lejitimit të parkimit të veturave në atë hapësirë

- Drejtoria e Inspekcioneve, përveç punëve të përditshme, po realizon në vazhdimësi edhe dy aksione të mëdha që ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe ndalimin e transportuesve ilegal të udhëtarëve të cilët operojnë në Komunën e Prishtinës dhe pengojnë jashtëzakonisht shumë rrjedhën normale të trafikut brenda qytetit. Kështu, duke vepruar sipas planit të Drejtorisë dhe ankesave/kërkesave të qytetarëve, inspektorët e rendit komunal kanë ndaluar dhe gjobitur një numër të madh të transportuesve ilegal të cilët po hidhnin dhe por edhe mbetje inerte në zona të ndryshme në periferi të qytetit të Prishtinës. Duke u nisur nga qëllimi primar i këtyre aksioneve e që është mbrojtja e mjedisit në Komunën e Prishtinës, Drejtoria e Inspekcioneve do të vazhdojë edhe në të ardhmen mbikëqyrjen dhe kontrollin e këtyre zonave të cilat potencialisht shfrytëzohen për hedhje të dheut dhe mbeturinave inerte kudo në Komunën e Prishtinës.
- Drejtoria e Inspekcioneve në vazhdim të aksioneve për lirim dhe hapësirave publike, ka ndërmarrë një aksion që kishte për qëllim lirim dhe hapësirave pranë hyrjes qendrore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës – QKUK-së. Gjatë këtij aksioni, Drejtoria e Inspekcioneve, në koordinim edhe me Ndërmarrjen “Hortikultura”, përveç lirim dhe hapësirave nga kiosqet dhe gjësendet tjera që shërbenin për shitje të mallërave të ndryshme e të cilat ishin të vendosura ilegalisht aty, ka bërë edhe pastrimin e gjithë kësaj zone nga grumbulli i madh i mbeturinave të krijuara në atë hapësirë.
- Drejtoria e Inspekcioneve gjithashtu ka larguar të gjitha konstruksionet e ndërtaura dhe vendosura pa leje të organeve komunale në sheshet qendrore të Prishtinës dhe në hapësirat mbi Kurriz në Dardani.
- Drejtoria e Inspekcioneve ka larguar lodrat e dëmtuara të cilat kishin zënë hapësirat në parkun e Tauk Bashqes dhe në lokacionin afër hapësirës së QKUK-së.
- Drejtoria e Inspekcioneve ka zhvilluar me dhjetëra aksione bashkë edhe me policinë e Kosovës kundër zhurmës e cila krijohet kryesisht nga lokalet e gastronomisë por edhe për të inspektuar respektimin e orarit të punës nga këto lloj biznesesh.

- Drejtoria e Inspekcioneve ka vazhduar të kujdeset për pyjet, dhe për dallim nga faza e parë kur kemi nisur mandatin, ka rënie të dukshme të prerjeve-dëmtimit të pyjeve. Me qëllim të parandalimit të prerjeve të pyjeve kemi pasur takime dhe kemi zhvilluar aksione të përbashkëta edhe me policinë e Kosovës.
- Drejtoria e Inspekcioneve në sektorin e ndërtimeve ka zhvilluar dhe zhvillon kontrolle të vazhdueshme të përputhshmërisë së ndërtimeve me lejet ndërtimore por edhe të ndërtimeve pa leje. Në këtë kuadër, në përputhje edhe me prioritetet dhe kapacitetet që kemi gjetur, kemi parandaluar me dhjetëra ndërtime pa leje, kemi zhvilluar nëntë (9) rrënime dhe tri (3) të tjera janë në pritje të ekzekutimit.
- Gjate inspektimeve të realizuara janë evidentuar gjithsejtë gjithsejtë 160 ndërtime, prej të cilave ka ndërtime të reja por shumica janë vazhdim i ndërtimeve nga vitet paraprake.
- Në total, përveç aksioneve në fjalë, Drejtoria e Inspekcioneve, ka trajtuar rreth një mijë e pesqindë (1500) ankesa dhe kërkesa të qytetarëve, prej të cilave disa i ka zgjidhur e një numër të tyre i ka ende në procedurë.

DREJTORIA E BUJQËSISË

Në kuadër të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, është duke u analizuar zonimi për katëgoritë e përmendura duke marrë marrë parasysh cilësinë e tokës dhe përshtatshmërinë për kulturat adekuate.

Kemi hapur thirrjen për aplikim për bujqit dhe kemi hapur tenderin për blerje të pajisjeve që do të shpërndahen. I gjithë procesi është në përfundim e sipër, jemi në pritje të përzgjedhjes së kompanisë fituese për ta implementuar projektin.

Fermere gra të cilat kultivojnë bimë aromatike mjekuese janë mbështetur përmes projektit SIREG, projekt ky i mbështetur nga ADA në Kosovë dhe implementuar nga Caritas që Komuna bashkëfinancon aktivitete bujqësore. Po ashtu, Komuna ka bërë thirrje për subvencionimin me pagesa direkte për të gjithë prodhuesit e bimëve mjekuese aromatike.

Në maj 2022 Komuna e Prishtinës ka organizuar një session trajnues/informues lidhur me menyrat e reja të aplikimit në subvencionët dhe grantët e MBPZHR.

Është inicuar modernizimi i tregut mobil dhe tashmë e ardhshmeja tregu Blej Shqip në datat 27-29 nëntor edhe me shitje online. Zyrtarët e Komunës së Prishtinës kanë pasur tri takime zyrtare me përfaqësuesit e tregut të gjelbër në Prishtinë me të cilët kanë diskutuar lidhur me modalitetët e ndërtimit të tregut të ri dhe lidhur me problemet që kjo kategori ka gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

Komuna e Prishtinës në këtë vit ka subvencionuar të gjitha ujitjet e tokave që fermeret kanë bërë përmes sistemit të Iber Lepencit

Projekti për pastrimin e lumenjëve dhe kanalizmit atmosferik është i gatshëm dhe pritet të hyn në procedurë të tenderimit gjatë muajit Shtator 2022. Pas pastrimit të lumenjëve dhe kanalizmit atmosferik, do të projektohet rregullimi i shtretëreve të lumenjëve nga Drejtoria e Investimeve Kapitale.



Kemi krijuar tregun e bizneseve të vogla, përmes shtëpizave në sheshin Edit Durham, ku 6 prej tyre janë biznese të grave start up (biznese me punë artizanale autoktone). Në Gusht është shpallur lista e përfituesëve.

Në secilën thirrje për aplikim në subvencione apo grante dhe tregun mobil nga Drejtoria e Bujqësisë, përparësi në përzgjedhje si fitues kanë pasur gratë fermere, po ashtu përmes Projektit SIREN, ku përfitues janë më shumë se 50 gra fermere vetëm në vitin 2022.

SUBVENCIONE NË BUJQËSI

Komuna e Prishtinës ka përkrahur sektorin e blegtorisë me subvencionim në vlerë prej 100,000.00 Eu, e gjedheve qumështore, deleve dhe dhive në formë të pagesave direkte .

Gjithashtu janë përkrahur edhe bletarët në formë të pagesave direkte. Në vlerë prej 50,000.00 Eu në mënyrë që të vazhdohet aktiviteti i tyre.

Kjo formë e përkrahjes bëhet me qëllim që këta sektor të rëndësishëm të mund të mbajnë një kontinuitet dhe të rrisin kapacitet e tyre prodhuese.

FURNIZIMI DHE MONTIMI I SERRAVE

Nga ky projekt kanë përfituar gjithësej 20 fermerë nga një serrë në sipërfaqe prej 0.02ha(8 fermer), 0.05ha(7 fermer) dhe 0.10 ha(5 fermer), vlera totale e kësaj mbështetje është 168,436.80 Eu. Projekti është në fazën përfundimtare të realizimit.

TREGU MOBIL

Gjithësej 50 fermerë do të kenë mundësi të ekspozimit të produkteve të tyre në tregun Mobil.

PROJEKTI “SIREĐ”

Bashkëfinancim mes Komunës së Prishtinës dhe Agjencinë Austriak për Zhvillim (ADA), implementues CARITAS. Komuna e Prishtinës gjatë kësaj periudhe ka alokuar mjete në vlerë prej 500,000.00 Eu.

Përfitues nga ky projekt janë agrobizneset në Komunën e Prishtinës me fokus të veçantë kultivuesit e bimëve aromatike mjekësore(BMA), përpunuesit e perimeve, kultivuesit e pemëve të imëta.

Në kuadër të këtij projekti një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe përkrahjes së gruas në bujqësi.

FURNIZIMI ME PAJISJE BLETARE

Jemi në fazën e mbështetjes për bletarët me centrifuga elektrike për nxjerrjen e mjaltit, depozitorë të mjaltit me kapacitet 50 kg, si dhe bluza për bletarë.

FURNIZIMI ME MOTOKULTIVATORË

Jemi në fazën e mbështetjes me pajisje në bujqësi- kultivatorë ka përfunduar faza e përzgjedhjes së fermerëve . Do përkrahen gjithësej 60 fermer

PËRKRAHJA E FERMERËVE PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE

Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me kompaninë Regjionale “Iber Lepenci”, ka përkrahur ujitjen e 200 ha, tokë bujqësore me kultura të ndryshme duke e subvencionuar 100% koston për ujitje.

FURNIZIM ME LAKTOFRIZË DHE ME MAKINA MJELËSE

Jemi në fazën e mbështetjes me pajisje në bujqësi- Laktofrizë dhe makina mjelëse ka përfunduar faza e përzgjedhjes së fermerëve . Do përkrahen gjithësej 30 fermer

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Monumentet, shtatoret, bustet, krojet publike dhe fontanat janë të planifikuara për mirëmbajtje të rregulltë duke përfshirë edhe rregullimin e tyre. Në të gjitha monumentet në sheshe është rregulluar ndriçimi, kurse kemi filluar edhe me riparimin e pjesëve tjera jashtë shesheve duke përfshirë hapësirat afër shkollave.

Projekti për riparimin dhe rregullimin e ashensorëve ka ndikuar në lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve, e në veçanti të personave me nevoja të veçanta, për të moshuarit, nënat me karroca dhe fëmijët e vegjël. Lokacionet në të cilat janë rregulluar ashensorët janë: Dardania, Sheshi Nëna Terezë, Bregu i Diellit, Lakrishtë dhe Kompleksi Qafa.

Për krijimin e hapësirave për lëvizje të lirë në stazat dhe vendkalimet për këmbësorë dhe ruajtjen e gjelbrimit nga parkimet e parregullta është realizuar projekti për vendosjen e rrethojave. Lokacionet në të cilat janë vendosur rrethojat janë:

- Kalabria-Rr. Tirana
- Kolovicë e Re-Rr.Açif Blyta
- Sheshi Nëna Terezë -Rr.Sylejman Vokshi
- Sheshi Nëna Terezë-Lagja Universiteti
- Lagja Dardania parking tek Santea dhe nënkalimi tek Termokos
- Ulpiana- rr.Mujë Krasniqi
- Mati-Rr.Muharrem Fejza
- Menza e Studentëve-rr.Eqrem Qabej

Mirëmbajtja e ndriçimit publik është në realizim e sipër. Gjatë fillimit të punimeve në kohë rekorde kemi arritur me sukses ta realizojmë rrjetin ndriçues në shumë lagje të qytetit. Jemi duke punuar me kapacitetet maksimale në teren dhe pak kohë do ta normalizojmë gjendjen në tërë rrjetin e ndriçimit publik.

Gjatë realizimit të të punimeve në investimet në hapësira publike është realizuar rivitalizimi i shkallëve në lokacionin e Daradnisë si dhe pikat tjera në rrethrrrotullim në rr.B.

- 1.** Punimi i rregullorë për transport rrugor në territorin e Komunës së Prishtinës;
- 2.** Punimi i rregullorë për ushtrimin e veprimtarisë së udhëtareve me taks;

3. Punimi i rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve të mikro-mobilitetit në Komunën e Prishtinës;
4. Punimi i rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës;

Lirimi nga pagesa e kategorive si:

- Personat me aftësi të kufizuara (me përcjellje);
- Personat Paraplegjik dhe Tetraplegji;
- Shërbimi Policor i Kosovës;
- Shërbimi i Zjarrfikëseve;
- Nxënësit e shkollave fillore të Komunës së Prishtinës;
- Veteranet me status “Veteran Luftëtare i Uçk”;
- Familjaret e dëshmoreve dhe të zhdukurve të luftës Uçk-së”
- Pensioniste e Komunës së Prishtinës (përveç në linjën 1);
- Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Riorganizimi i linjave dhe dizajnimi i linjave të transportit publik; Ofrimin e shërbimit të transportit publik deri në orën 24:00, në këto linja:

- Linja numër 1;
- Linja numër 1A;
- Linja numër 3;
- Linja numër 4.

Lirimi nga pagesa në dy stacionet e fundit në linjën numër 3, në linjën 7C në stacionin e fundit ti vlej bileta e qytetarit që korrespondon me kohën e pagesës për afërsisht 5 min me kohë e nisjes së autobusit të fundit.

IMPLEMENTIMI I PLANIT TË MOBILITETIT DHE REKOMANDIMET E TASK FORCËS

- Në kuadër të Tasks Forcës janë zgjedhur disa problematika në trafikun rrugor, si dhe të njëjtën kohë është bërë dhe intervenim në terren sipas rekomandimeve të Tasks Forcës si në vijim:
- Rregullimi i qarkullimit në rrugën “Hekurudha: në drejtim të rrugës Magjistrale M-2 (Mitrovic Prishtinë)
- Testimi dhe analiza i qarkores me rrugë një kahore rr. “Agim Ramadani”, rr. “UÇK-së”, rr. “Migjeni”, rr. “Luan Haradinaj”, rr. “Ukshin Hoti”, rr. “Robert Doll”.
- Rregullimi i qarkullimit të mjeteve motorike në rrugën “Fatime Sokoli”, rr. Ilizaj Kodra”, rr. Magjistrale M-2.

SHTYLLAT ANTIPARKING DHE PISTONAT LËVIZËSE ME SHENJËZIM

- Sinjalizimi i vend kalimeve në afërsi të shkollave
- Sinjalizimi i vendkalimeve të këmbësorve në afërsi të shkollave, dhe në disa rrugë.
- Rruget qe janë imlementuar deri me tani janë si në vijim;
- 1.Shkolla "Hasan Prishtina", në lagjen Ulpiana
- 2.Shkolla "Xhejmal Prishtina", në lagjen Dardania,
- 3.Shkolla "Dardania", në lagjen "Dardania",
- 4.Shkolla "Gjergj Fishta",
- 5.Shkolla "Gjin Gazulli",
- 6.Shkolla "Zenel Hajdini",
- 7.Shkolla "Afrim Gashi", Hajvali
- 8.Shkolla "Shkendija", Hajvali

MIREMBAJTJA DIMERORE

Mirëmbajtja dimërore organizohet përmes 11 operatorëve, 7 nga të cilët në zonën urbane dhe 4 në atë rurale. Përmes mirëmbajtjes dimërore të zonës urbane mirëmbahet hapësira me sipërfaqe totale 2,649,651.5m², derisa të zonës rurale mirëmbahet hapësira me sipërfaqe totale 1,535,691.0 m². Gjatë mirëmbajtjes dimërore në periudhat kur ka reshje/ngrica planifikohet hapja e rrugëve dhe trotuareve nga bora dhe eliminimi i ngricave në rrugët dhe trotuaret 24/7. Derisa në periudha kur temperaturat janë mbi 5°C realizohet fshirja si dhe larja e tyre.

Komuna e Prishtinës e ka të mbuluar tërë territorin me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Ofrimi i shërbimit në zonën urbane me ndërtesa kolektive realizohet përmes kontejnerëve publikë derisa në zonat urbane me banim individual si dhe në zonën rurale shërbimi ofrohet derë më derë. Për të dy sistemet ka të hartuar planin operativ në bashkëpunim me KRM "Pastrimi", ku në mënyrë të rregullt bëhet grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave deri në deponinë sanitare në Mirash.

LARGIMI I DEPONIVE ILEGALE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS

Përveç sistemit të rregullt të menaxhimit të mbeturinave, Komuna e Prishtinës ballafaqohet me problemin e krijimit të deponive ilegale. Në fillim të vitit 2020 janë identifikuar **145 deponi ilegale**, ku deri në përfundim të vitit 2021 Komuna e Prishtinë ka arritur ta reduktoj numrin e deponive ilegale në 6 deponi ilegale. Megjithatë si pasojë e hedhjes së mbeturinave në formë ilegale në fillim të vitit 2022 në territorin e Komunës së Prishtinës ishin 26 deponi ilegale, ku në gjashtëmujorin e pare u larguan 24 nga to



duke **reduktuar numrin në 2 deponi ilegale**. Në anën tjetër, largimi i deponive të vogla ilegale realizohet në baza ditore përmes shërbimit të grumbullimit të mbeturinave. Për më tepër, me qëllim të parandalimit të rikrijimit të deponive të tilla, aty ku është e mundshme, kemi filluar edhe rrethimin e lokacioneve me, trajtimin sipërfaqësor dhe mbjelljen e fidaneve. Në mënyrë që të sigurohet një qëndrueshmëri e projektit, Komuna e Prishtinës ka lidhur marrëveshje me **Agjencionin Pylor të Kosovës** për rivitalizimin e lokacioneve ku largohen deponit ilegale.

OFRIMI I SHËRBIMIT PËR GRUMBULLIMIN E MBETURINAVE TË VËLLIMSHME

Komuna e Prishtinës në kuadër të hapave konkret drejt krijimit të një ambienti të pastër dhe përmirësimit të kualitetit të jetesës së qytetarëve të saj, ofron shërbimin për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme në të gjithë territorin e saj. Ky shërbim ofrohet çdo dy muaj dhe ka për synim minimizimin e ndikimit që mund ta ketë në mjedis mbeturina. Përmes këtij shërbimi është arritur të reduktohet numri i deponive ilegale dhe njëkohësisht përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave. Ky hapë është hapi i parë i komunës drejt mbledhjes së diferencuar të mbeturinave, e që në një të ardhme të afërt parashihet edhe mbledhja e rrymave tjera të mbeturinave në bazë të një kalendari mujor që parashihet të bëhet.



RIORGANIZIMI I LOKACIONEVE TË KONTEJNERËVE NË LAGJEN MATI

Projekti i riorganizimit të lokacionit të kontejnerëve në lagjen Mati është një nga disa projekte të realizuara në bashkëpunim me GIZ. Ky projekt ka për qëllim analizën e lokacionit më optimal për vendosjen e kontejnerëve, duke marrë për bazë qasjen sa më të lehtë të qytetarëve, distancën optimale nga banesa/shtëpia e tyre, sigurinë në komunikacion të tyre si këmbësor por edhe të automjeteve, qasjen e automjetit për zbrazjen e kontejnerëve, si dhe anën vizuale dhe sociale që mund të ketë ky lokacion në raport me hapësirën përreth. Gjatë kësaj analize përveç lokacioni është punuar edhe në përcaktimin e numrit optimal të kontejnerëve.

MIRËMBAJTJA E VERORE E RRUGËVE DHE TROTUAREVE

Përmes mirëmbajtjes verore organizohet fshirja dhe larja e rrugëve dhe trotuareve të zonës urbane. Ky shërbim bëhet duke ndarë zonën urbane në 6 lloto. Mirëmbajtja verore është organizuar duke kategorizuar rrugët sipas numrit të automjeteve dhe këmbësorëve që qarkullojnë në to dhe përfshin katër kategori. Në 2022 duke pas për bazë organizimin e Manifestes në Komunën e Prishtinës kemi rritur numrin e larjeve dhe fshirjeve gjatë periudhës verore. Për dallim nga vitet tjera gjatë vitit 2022 përmes kontratës së mirëmbajtjes

verore është organizuar edhe pastrimi i parkingjeve, hapësirave përcjellëse, rrugëve dhe trotuareve në shumë lokacione ku nuk është intervenuar më parë.

PASTRIMI DHE DEZINFEKTIMI I KONTEJNERËVE DHE HAPËSIRËS PËRRETH

Përmes kontratës me KRM Pastrimin është paraparë edhe pastrimi i lokacioneve të kontejnerëve me detergjent, punë e cila do të ndikoj në krijimin e një ambienti më të përshtatshëm për qytetarët e Prishtinës. Përveç pastrimit të lokacionit, është paraparë edhe pastrimi i vet kontejnerëve. Kjo punë realizohet në koordinim me ekipet të cilat bëjnë zbrazjen e kontejnerëve.

FURNIZIMI ME SHPORTA PËR MBETURINA TË XHEPIT

Organizata Help në bashkëpunim me Shërbimin Korrektues e përkrahur nga Komuna e Prishtinës, ka zhvilluar projektin për furnizim të hapësirave publike me shporta. Shportat e furnizuara janë punuar nga të burgosurit e Burgut të Dubravës, të cilët fillimisht janë trajnuar nga organizata Help. Këto shporta janë vendosur kryesisht në afërsi të hapësirave shkollore, si Elena Gjika, Shkolla e Gjelbër, Hasan Prishtina etj.

NDËRTIMI I QENDRËS SË KOMPOSTIMIT

Në bashkëpunim me **GIZ** (Shoqëria për Bashkëpunim Ndërkombëtar) nga Gjermania dhe **CMSR** (Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim) nga Sllovenia Komuna e Prishtinës ka realizuar projektimin dhe ndërtimin e Qendrës së Kompostimit. Kjo qendër është e para në Republikën e Kosovës dhe jo vetëm dhe ka për qëllim **riciklimin e mbeturinave** të gjelbra. Kjo qendër ka tejkalluar edhe vendet e rajonit me teknologjinë e shfrytëzuar duke përdorur sistem të ajrimit të kompjuterizuar dhe sistem të kontrollimit kompjuterik temperaturës të cilat ndikojnë shumë në cilësinë e produktit final si dhe njëkohësisht kohën e nevojshme për kompostim. Produkti final i qendrës së kompostimit është pleh natyral i cili parashihet të shfrytëzohet në zhvillimin e bimëve të ndryshme dekorative të cilat Komuna e Prishtinës do ti përdorë në hapësirat e gjelbra dhe parqet e qytetit. Përfitimet kryesore nga ky projekt janë:

- Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që dërgohen në deponi;
- Zvogëlimi i kostos në transport dhe deponimi;
- Përfitimi i kompostit për plehërim dhe kultivim të fidaneve pa kosto financiare;
- Ndërmarrjen e hapave konkret drejt plotësimit të standardeve të parapara nga Bashkimi Europian.

LIDHJA E MEMORANDUMEVE TË BASHKËPUNIMIT ME GAC DHE APK

Pasi që menaxhimi i mbeturinave dhe mbrojtja e mjedisit është njëra nga sfidat më të rëndësishme të Komunën e Prishtinës por edhe në nivel shteti dhe rajoni, qasja konstruktive dhe bashkëpunimi me akter të ndryshëm është i rëndësishëm së veçantë. Në kuadër të këtij koncepti përveç bashkëpunimit me GIZ, CMSR dhe Help, Komuna e Prishtinës gjatë gjashtëmujorit të parë ka lidhur memorandum bashkëpunimi me Agjencionin Pyjor të Kosovës si dhe Green Art Center. Përmes MOU me APK parashihet bashkëpunimi i komunës rreth rivitalizimit të hapësirave të ndryshme, të cilat paraqesin ish-in deponi ilegale. Derisa përmes MOU me GAC parashihet bashkëpunimi rreth avancimit të sistemit të menaxhimit të mbeturinave.

HARTIMI I PLANIT PËR MENAGJIMIN E MBETURINAVE

Në bashkëpunim me GIZ ka filluar hartimi i Planit për Menaxhimin e Mbeturinave". Bazuar në hapat e planifikuara ky plan do të përfundojë në fund të muajit Tetor kur edhe pritet të hidhet në votim në Asamblen Komunale. Ky plan do të parashoh të gjithë hapat që parashihet të ndërmerren në këtë fushë në pesë-vjeçarin e ardhshëm si ndërtimin e qendrave për pranim dhe trajtim të mbeturinave, plotësim ndryshim e rregullores, riorganizimin e ofrimit të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave etj.

TRAJTIM I QENVE ENDACAK

Njëra nga sfidat më të mëdha në Prishtinë dhe jo vetëm është edhe menaxhimi me kafshët endacake. Duke pas parasysh numrin e lartë të tyre, dhe rrezikun që ata paraqesin për këmbësorë, Komuna e Prishtinës ka paraparë ndarjen e qytetit në 7 lloje dhe tenderimin e tyre. Kjo është bërë për herë të parë, dhe ka pasë për qëllim një monitorim më të lartë të situatës në teren. Përmes këtij projekti parashihet vaksinimi dhe sterilizimi i tyre.

NDËRTIMI I STREHIMORES PËR QENTË ENDACAK

Ky projekt është në fazë të prokurimit, dhe parashihet të fillojë këtë vit. Ndërtimi i kësaj qendre është kryesor pasi që kjo do të ndikoj në një qasje komplet tjetër të komunës së Prishtinës në raport me qentë endacak.

NDËRTIMI I 18 PIKAVE USHQYESE PËR QENTË ENDACAK

Duke e parë rrezikun që qentë endacak po paraqesin për banorët e komunës së Prishtinës, megjithëse në qytet parashihet të ndërtohet një qendër për trajtimin e tyre, për të ulur agresivitetin e tyre në mungesë të ushqimit ka ndërtuar 18 pika ushqyese.



TAKIME ME BANORË NË LAGJE

Duke marrë parasysh kërkesat e shumta të banorëve nëpër lagjet e qytetit, kemi filluar turin e dëgjimit në mënyrë që bashkarisht të gjejmë zgjidhje të përbashkët me komunitetin. Problemet me mbeturina, shfrytëzimin e hapësirave publike, mirëmbajtjen e ndriçimit janë ndër problemet që më së shumti banorët e lagjeve të ndryshme të qytetit përballen. Andaj si drejtori e Shërbimeve Publike jemi zotuar në përmirësimin e kushteve, ambientit ku qytetarët kanë nevojë për një ambient më të pastër.

Deri më tani kemi vizituar lagjet si : Emshir (Kalabria), Kodra e Trimave, Hajvalia, Bardhosh, Sharban, Kolovica, Mati. Në vazhdimësi këto takime jemi duke i shfrytëzuar si drejtori për planifikimin e punës në teren.

ORGANIZIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE NË VIKEND

Drejtorja e Shërbimeve Publike, në vazhdimësi është duke organizuar ofrimin e shërbimeve në lagje të ndryshme në vikend, me qëllim të përmirësimit të ambientit në lagjet e qytetit. Këto aksione përfshijnë:

- Pastrimin e thellë të lagjeve
- Largimin e deponive të vogla ilegale

- Rregullimin e problemeve me ndriçim publik
- Shenjëzimin e hapësirave
- Ngritjen e sigurisë anësore të rrugëve
- Vendosja e rrethojave për siguri të këmbësorëve
- Revitalizimi i hapësirave të gjelbërta
- Trajtimi i qenve endacak

Arsyeja pse këto aksione janë realizuar në vikend është sepse numri i veturave në komunikacion është më i vogël, pra komunikacioni nuk është i dendur, kordinimin mes gjitha kompanive të përfshira në aksion dhe qytetarët mund të jenë pjesë e këtyre aktiviteteve si monitorues apo si pjesëmarrës në aktivitet, duke shprehur ide , sugjerime rreth aktiviteteve në vikend.

SHQYRTIMI I KËRKESAVE ME SHKRIM

Drejtoria e Shërbimeve Publike, vazhdimisht ka pranuar kërkesa të ndryshme me shkrim lidhur me shfrytëzimin e hapësirave publike. Gjithmonë bazuar në afatet ligjore kërkesat me shkrim janë shqyrtuar dhe më pas janë përcjellur tek palët përgjigjet positive qoftë edhe ato negative varësisht nga lloji i kërkesës për shqyrtim. Deri më tani është bërë pranimi i 2241 lëndëve, të shqyrtuara 2010 lëndë, kurse në proces janë 231 lëndë për shqyrtim.

ORGANIZIMI I AKSIONIT PËR “ DITËN E TOKËS”

Ky aksion është zhvilluar gjatë një muaji të plotë duke filluar nga 22 marsi, dhe duke vazhduar deri me 22 Prill kur edhe është përmbyllur. Gjatë javëve të para është intervenuar janë larguar deponit përmes kontratës me KRM Pastrimin derisa në javën e fundit janë mbajtur edhe aktivitete të ndryshme, si:

- “Ec e pastro” në Parkun Gërmia aktiviteti ky i organizuar me grupe të ndryshme të vrapimit aktive në park,
- Eliminimi i deponive dhe ridestiniimi i hapësirave publike, aktivitet ky i organizuar në bashkëpunim me CSR dhe APK
- Vendosja e shportave në hapësira publike, aktivitet ky i organizuar me organizatën Help
- Revitalizimi i hapësirave përcjellëse të Fabrikës së Tullave aktivitet i mbështetur edhe nga FSK, PK, Zjarrfikësit
- Rrethimi i hapësirave të cilat me vite të tëra janë shfrytëzuar si deponi

Të gjitha këto aktivitete kanë kontribuar në një ambient më të pastër dhe një numër dukshëm më të ulët të deponive, nga deponitë më të mëdha të larguara gjatë këtij

aktiviteti vlenë të ceket deponia përgjatë kolektorit në lagjen Kalabria e cila e vetme kishte rreth 20,000.00m³.

LARGIMI I MBETURINAVE TË ASBESTIT

Komuna e Prishtinës është ndër komunat e para të cilat kanë filluar ta trajtojnë edhe çështjen e mbeturinave të rrezikshme, me këtë rast ka filluar të bëjë hapa konkret drejt largimit të azbestit nga hapësirat publike. Projekti ka filluar me largimin e kulmit të bibliotekës "Hivzy Sylejmani" e cila ishte e mbuluar me mbulojë me përbërje asbesti në sasi prej 120m². Duke pas parasysh shëndetin publik dhe rrezikun që potencialisht kjo rrymë e mbeturinave mund ta shkaktoj tek qytetarët, Komuna e Prishtinës realizoj të gjitha hapat e nevojshme për deponimin e këtyre mbetjeve. Ky projekt u realizuar në bashkëpunim, me UNDP ,ndërsa projekti do te vazhdon edhe per hapësirat tjera dhe ate ne bashkëpunim me MM dhe në koordinim me MMPHI.

AKTIVITETET E ZHVILLUARA NGA SEKTORI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Me iniciativën e Drejtorisë DSHP dhe me prezencën edhe përkrahjen e Kryetarit Rama, mbajtëm punëtorinë me temën "Punësimi, Ndërmarrësia dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm në Sektorin Privat në Komunën e Prishtinës". Në takim ishin të pranishëm donatorë dhe ambasada që mbështesin projekte të punësimit në sektorin privat dhe përkrahjen e qëndrueshmërisë së bizneseve start-up dhe ekzistuese.

Fokusi kryesor i kësaj punëtorie ishte mundësia e bashkëpunimit me komunën e Prishtinës në implementimin e projekteve për rritjen e punësimit dhe mbështetjen e sektorit privat.

Shumë shpejtë DSHPMSH përmes sektorit për zhvillim të qëndrueshëm, brenda drejtorisë do hartojë planin e veprimit sipas prioriteteve dhe nevojave në Komunën e Prishtinës, me qëllim të uljes së papunësisë dhe përkrahjen e sektorit privat për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

prishtinaonline.com

